

Përkrahja e të lexuarit në gjuhën e parë



Materiale për mësimin në gjuhën e prejdardhjes

Nxitje didaktike

2

Përkrahja e të lexuarit në gjuhën e parë

Maria Riss

Elisa Aeschimann-Ferreira
dhe Raquel Rocha

Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes

Nxitje didaktike

2

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» (MGJP; në Zvicër GJKA: Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut); Nxitje didaktike 2.

Botuar nga Qendra IPE (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike.



Udhëheqës i projektit: Basil Schader

Autore: Maria Riss, docente dhe udhëheqëse e projektit në qendrën për të lexuarit në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Shkollës së Lartë Profesionale në Zvicrën Veri-Lindore; autore tekste të mësimore në fushën e përkrahjes së të lexuarit.

Redaktimi nga ana e MGJP: Elisa Aeschmann-Ferreira dhe Raquel Rocha


Mësuesit/et provues/e: Nexhat Maloku, Cyrih (GJKA shqip)
Hüsniye Göktaş, Cyrih (GJKA turqisht)
Dragana Dimitrijević dhe Gordana Nikolić,
Cyrih (GJKA serbisht)
Elisa Aeschmann-Ferreira dhe
Raquel Rocha (GJKA portugalisht)
Hazir Mehmeti, Vjenë
Rifat Hamiti, Dyseldorf

Ilustrimet, koncepti i përgjithshëm pamor dhe realizimi: Barbara Müller, Erlenbach

Përkthimi: Nexhat Maloku, M.A.

Shtypi: Shtypshkronja Printing Press, Prishtina/Kosova

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» u mundësua me përkrahjen e Entit Federal për Kulturë (BAK).



Ky projekt u financua pjesërisht me përkrahje të Komisionit Evropian. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij botimi e bartin vetë hartuesit/et; Komisioni nuk merr përgjegjësinë për përdorimin e mëtejshëm të të dhënave të përmbajtjes.



Numri ISBN i botimit përkatës gjermanisht:

ISBN 978-3-280-04119-2

Pasqyra e përmbajtjes

Parafjalë për serinë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»	7
---	----------

Hyrje

1 Të lexuarit në gjuhën e prejardhjes: përfitimet dhe vështirësitë	8
2 Qëllimi dhe ndërtimi i kësaj fletoreje	10
3 Pikat kryesore të didaktikës aktuale të të lexuarit	10
4 Pika plotësuese në lidhje të ngushtë me të lexuarit në mësimin në gjuhën e prejardhjes	13

Pjesa I: **Përkrahja e të lexuarit**

Të merresh me libra dhe tekste

1 Të lexosh para të tjerëve si ritual	20
2 Të hapet një bibliotekë e vogël në gjuhën e parë	21
3 Huazimi i librit tek institucionet si «Bibliomedia»	22
4 Vizita në bibliotekë	22
5 Libra-domino	23
6 Fjalitë e para	24
7 Të shtrohen hipotezat	25
8 Libra në qesen e mrekullueshme	26

Librat dhe tekstet të lexohen dhe të kuptohen

9 Sekuenca të lira leximi	27
10 Leximi para të tjerëve dhe incizimi i zërit për të tjerët	28
11 Leximi në grup ose me tërë klasën	29

Të flitet për librat e lexuar

12 Kush e gjen librin tim?	32
13 Peri i gjëegjësës	33

14	Pyetjet për librat të përpunohen	34
15	Të modelohet pllakat-reklamë për një libër	35
16	«Book-Slam» (për kuptimin shiko te «Vërejtje»)	36
17	«Book-Dating» (për kuptimin shiko te «Vërejtje»)	37

Të pasqyrohet të lexuarit

18	Leximi para të tjerëve: të vlerësosh vetveten	38
19	Të rishihet të lexuarit personal	39

II Pjesa II: Ushtrimi në të lexuar

Aftësitë në të lexuar

20	Unë i njoh menjëherë shkronjat	44
21	Unë i lexoj fjalët gjithnjë e më shpejt	45
22	Unë i shoh fjalitë si tërësi	47
23	Unë e kuptoj atë që e lexoj	48

Rrjedhshmëria në të lexuar (Fluency)

24	Të ushtrohet rrjedhshmëria	50
----	----------------------------	----

Strategjitë e të lexuarit

25	Strategjitë para se të nisë të lexuarit	53
26	Strategjitë gjatë të të lexuarit	54
27	Strategjitë pas të të lexuarit	55

III Pjesa III: Arsimimi letraro-kulturor

28	Të dëgjuarit	60
29	Personazhet e librit	61
30	Të përfytyrohet një vend nëpërmjet pamjeve	63

	Literatura e përdorur	64
--	------------------------------	----

Sqarimet, shkurtesat

Gjuha e parë: Edhe gjuhë amtare – ose familjare: gjuha të cilën një fëmijë e ka mësuar dhe folur si gjuhë të parë në shtëpi. Mjaft fëmijë kanë dy gjuhë.

Gjuha shkollore: Gjuha e cila flitet në shkollën e vendit emigrues. Gjithashtu mund të vijë edhe dialekti lokal si gjuhë e rrethit

Shkurtesat: N = Nxënës, nxënëse
M = Mësues, mësuese

Legjenda

për të dhënat për formën sociale, klasën dhe kohën e nevojshme tek propozimet mësimore:



PI = Punë individuale



PP = Punë me partner



GV = Grup i vogël



TK = Tërë klasa

kl. 1–9

E përshtatshme për klasat ... deri ... (p.sh. kl 2–4). Kujdes: Kjo renditje mund të ndryshojë sipas parakushtit të nxënësit,-es veç e veç.

10–15 min.

Nevoja për kohë të përafërt, p.sh. 20 min. (e dhënë e përafërt, duhet të vendoset nga mësimdhënësi sipas gjendjes së parakushteve të klasës).

Parathënie për serinë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»

Mësimi në gjuhën amtare ose të prejardhjes (MGJP; në Zvicër GJKA, mësimi në gjuhën dhe kulturën e atdheut) luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin gjuhësor dhe të identitetit si dhe për përkujdesjen për shumëgjuhësinë, si një rekurs vetjak dhe shoqëror me shumë vlerë. Lidhur me këtë fakt, hulumtimet, linjat drejtuese, si edhe rekomandimet e Këshillit të Evropës R(82) 18 dhe R (98) 6, janë të qarta që prej shumë kohësh. Megjithatë ky mësim zhvillohet, në krahasim me mësimin e rregullt, ende në kushte të vështira. Kjo gjë ndodh për arsye të ndryshme:

- Mësimi në gjuhën e prejardhjes në shumë vende, përsa i përket aspektit financiar dhe institucional, qëndron në themele të dobëta. Pagesa e mësimdhënësve në Zvicër është pothuaj si kudo çështje e vendeve të prejardhjes madje edhe e prindërve.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është më së shumti i lidhur jo mirë me mësimin e rregullt. Kontaktet dhe bashkëpunimi me mësimdhënësit e klasave të rregullta, shpesh zhvillohen shumë dobët.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes zhvillohet në më të shumtën vetëm dy orë në javë, gjë që e vështirëson punën në vazhdimësi.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është, në të shumtën, vullnetarisht, detyrimi për nxënësit nuk është shumë i fortë.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes, si rregull, zhvillohet si mësim në shumë klasa, në të cilin marrin pjesë njëkohësisht nxënës që nga klasa e parë e deri në klasën e nëntë. Kjo kërkon nga mësimdhënësit aftësi të lartë didaktike si edhe aftësi për të diferencuar nxënësit në klasë.
- Heterogjeniteti i bashkësisë së nxënësve në mësimin e gjuhës së prejardhjes është veçanërisht shumë i lartë edhe në raport me kompetencat gjuhësore të nxënësve, ndërkohë kur disa sjellin nga shtëpia njohuri të mira në variantet dialektore ose të standardit të gjuhës së parë, të tjerë e flasin këtë vetëm në dialekt. Shumica që jeton tashmë në gjeneratën e dytë apo të tretë në vendin e ri të emigrimit, gjuha e atij vendi (p.sh. gjermanishtja) është bërë gjuhë e fortë, derisa gjuhën e parë e zotërojnë vetëm në variantin dialektor, dhe atë vetëm gojarisht dhe me një leksik të kufizuar rreth temave familjare.

- Mësuesit e gjuhës së prejardhjes parimisht kanë marrë në vendet e tyre të prejardhjes një arsimim të mirë bazë, por nuk janë të përgatitur për realitetin dhe specifikat e mësimin në shkollat me shumë klasa në emigrim. Mundësitë e kualifikimit në vendet e emigrimit zhvillohen në masë ende të pamjaftueshme.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» i përkrah mësimdhënësit e këtij mësimi në detyrën e tyre të rëndësishme e me kërkesa të larta, e me këtë dëshiron të japë ndihmesë për një cilësi maksimale të tij. Nga njëra anë është me rëndësi dhënia e principeve dhe e arsyeve të pedagogjisë dhe didaktikës në vendet emigruese perëndimore dhe evropianoveriore, (krahaso fletoren «Bazat dhe sfondet») nga ana tjetër dhënia e shtysave dhe modeleve mësimore praktike e konkrete. Përparësi përbën këtu përkrahja e kompetencave gjuhësore. Tek shtysat didaktike në mënyrë të vetëdijshme përdoren principet dhe metodat, të cilat për nxënësit janë të njohura nga mësimi i rregullt dhe tekstet mësimore përkatëse. Për këtë do të duhej që mësimi në gjuhën e prejardhjes dhe mësimi i rregullt, mundësisht t'i afrohen njëri-tjetrit në kuptim të një koherence të madhe. Përmes faktit që mësimdhënësit e mësimin në gjuhën e prejardhjes, njohin edhe elemente didaktike dhe metoda konkrete, që janë aktuale tek nxënësit në mësimin e rregullt, ata bëjnë njëkohësisht një pjesë kualifikimi dhe shpresojmë për një forcim të formimit të tyre si partnerë të barasvlershëm në procesin arsimor me nxënësit e rritur në sfondin dygjuhësor respektivisht dykulturor.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» botohet nga Qendra «International Projects in Education (IPE)» dhe Shkolla e Lartë Pedagogjike Cyrih. Ajo lindi mes një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet personave profesionistë zviceranë, atyre evropianoperëndimor në njërin anë, dhe të ekspertëve e mësimdhënësve të mësimin në gjuhën e prejardhjes, nga ana tjetër. Me këtë do të sigurohet se dhënia e informacioneve dhe e shtysave u përgjigjet gjendjes faktike, nevojave dhe mundësive të mësimin në gjuhën e prejardhjes dhe se janë funksionale e praktike për këtë mësim.

Hyrje

1. Të lexuarit në gjuhën e prejardhjes: përfitimet dhe vështirësitë

Se sa e rëndësishme është që të mund të lexosh dhe të shkruash në gjuhën e prejardhjes, është e qartë: kush nuk i zotëron këto aftësi letrare, mbetet në mënyrë të pashmangshme analfabet/e në gjuhën e tij të parë, e humb lidhjen me kulturën e tij të shkruar dhe rrezikohet seriozisht në zhvillimin e tij dykulturor-dy-gjuhësor-dyletrar. Përkundrazi, kush i zotëron kompetencat letrare edhe në gjuhën e parë, atij i hapen mundësi të pasura dhe të shumëllojshme. Ato varen nga kontakti me literaturën e popullit të vet e deri te mundësia që, në mërgim dhe në vendin e prejardhjes, të marrë pjesë në jetën e shkruar dhe, ndoshta, t'i plotësojë përfitimet e tij profesionale me një aspekt shumë të vlefshëm.

Së paku tek ato gjuhë të para, të cilat e përdorin alfabetin latin, në shikim të parë, nuk do të duhej të presim edhe aq probleme për sa i përket të lexuarit. Kjo nuk është e drejtë: probleme dhe vështirësi ka mjaft. Ne mund t'i përmbledhim në tri grupe:

a) Problemet me inventarin e grafemave (shkronja të veçanta dhe theksa) dhe radhitja e shkronjave

Shumica e gjuhëve kanë shenja të veçanta (ë, ç, ð, ĉ, ș, ģ, ı, â, æ, ç, ā etj.). Këto grafema nuk mësohen në kuadër të mësimin të rregullt në shkollat e vendeve mikpritëse. E njëjta gjë vlen edhe për vlerat fonetike të grafemave të veçanta (Shembull: <z> ka në gjermanisht vlerën fonetike ts, kurse në shumicën e gjuhëve të tjera përfaqësohet si s e zëshme; <c> në turqisht ka vlerën fonetike dsch, në gjuhët sllave ka vlerën fonetike ts dhe në gjermanisht vlerën fonetike ts ose k). Disa vlera fonetike rikthehen në mënyra të ndryshme sipas gjuhës. Kështu <sch> së gjermanishtes i përgjigjet p.sh. <sh> në anglisht dhe në shqip, në turqisht <ş>, në gjuhët sllave <š> etj. Edhe renditja e shkronjave në fjalor nuk është kudo e njëjtë; kështu, p.sh. fjalët me ö dhe me ü në turqisht qëndrojnë pas fjalëve me o- dhe u-, kurse në gjermanisht ato janë të integruara te këto, kurse në anglisht dhe në portugalisht nuk paraqiten fare. Të gjitha këto veçori fëmijët duhet t'i mësojnë në shtëpi ose në MGJP, nëse duan që gjuhën e tyre ta lexojnë dhe ta shkruajnë rrjedhshëm. Në mënyrë që t'i menjanojnë këto pështjellime, shumë mësues/e të MGJP ua mësojnë nxënësve këto veçori në përfundim të klasës së parë ose në fillim të klasës së dytë. Tek alfabetet jolatine është e kuptueshme që i tërë alfabetizimi të zhvillohet në gjuhën e parë.

b) Problemet me variantin e standardit të gjuhës së parë:

Shumë fëmijë dhe të rinj e flasin gjuhën e tyre të parë vetëm në një variant dialektor. Kjo ndryshon nga njëherë aq fort nga gjuha standarde (p.sh. tek disa të folme gojore të Italisë Jugore ose të Shqipërisë Veriore), sa që sjell probleme serioze, sidomos tek të lexuarit. (Tek të shkruarit ato janë pak më të vogla, sepse këtu mund të shkruhet edhe në dialekt.) Një hyrje e kujdesshme në variantin standard dhe të shkruar të gjuhës amtare është një prej detyrave më të rëndësishme të mësimin MGJP, kur bëhet fjalë për të siguruar hyrjen në kulturën e shkruar të gjuhës amtare. Kjo është veçanërisht e vlefshme për fëmijët nga familjet me arsimim të ulët, të cilat në shtëpi kanë pak ose aspak kontakt me variantin e shkruar ose standard të gjuhës së tyre.

c) Problemet në lidhje me mungesën e traditës letrare dhe të përkrahjes nga ana e familjes

Ky lloj i vështirësive dhe problemeve nuk është i veçantë për MGJP, shumë më tepër ka të bëjë me arsimimin e lartë apo të ulët të prindërve. Në mënyrë të përgjithshme mund të thuhet: Fëmijët dhe të rinjtë të cilët nga mjedisi shtëpiak janë mësuar të merren me librat dhe shkrimin, në mënyrë të qartë kanë parakushte më të mira në shoqëritë dhe shkollat tona të orientuara nga teksti dhe shkrimi, se sa tek ata të cilët mungojnë këto parakushte. Natyrisht këtu preket posaçërisht të lexuarit në gjuhën e parë, ndërsa të lexuarit në gjuhën e shkollës përkrahjet vite me radhë nëpërmjet mësimin të rregullt. Tek kompensimi i këtyre mangësive, MGJP mund të luajë një rol të rëndësishëm. Kjo është edhe më e rëndësishme, sepse të mësuarit e nxënësve përkatës, nuk është vetëm në dobi të MGJP, por edhe të të mësuarit rregullisht.

Rreth çështjes «Ku qëndrojnë problemet kryesore të nxënësve/eve në fushën e leximit në gjuhën e parë në MGJP?» ne kemi hartuar paraprakisht një pyetësor me mësuesit/et e MGJP. Përgjigjet u shkojnë përshtat tri kategorive, ashtu siç e tregojnë shembujt vijues:

-
- «Nxënësit/et, në gjuhën shqipe, nuk mund t'i dallojnë shqiptimet e shkronjave q, ç, gj, xh, sh etj, gjithashtu ata kanë vështirësi me gjuhën tonë standarde.»
-
- «Nxënësit/et kanë vështirësi me shenjat e veçanta të gjuhës turke. Për më tepër ata nuk i dinë shumë fjalë, sepse leksiku i tyre është shumë i varfër.»
-
- «Një problem janë pasiguritë tek shkronjat e veçanta të gjuhës sonë dhe tek shqiptimi i shkronjave të ndryshme. Nxënësit/et natyrisht nuk i kanë mësuar këto dallime në mësimin e rregullt. Unë duhet që këto t'i përpunoj dhe t'i ushtroj me të vegjlit me shumë kujdes, sepse, në të kundërtën, ata bëjnë gjithnjë shumë gabime në të shqiptuar ose i ngatërrojnë disa shkronja.»
-
- «Numri i pakët i orëve gjatë javës dhe, si pasojë, kontakti i rrallë i nxënësve/eve me gjuhën standarde, e vështirëson përvetësimin e të lexuarit. Shumica e nxënësve/eve flasin në shtëpi në dialekt dhe nuk përkrahen pothuajse fare nga prindërit.»
-
- «Tek të lexuarit në gjuhën e parë kemi një problem, sepse nxënësit/et e bëjnë këtë kryesisht në MGJP dhe pothuajse fare në shtëpi. Një vështirësi tjetër është që ata flasin variantin dialektor në shtëpi. Prandaj ata kanë vështirësi t'i lexojnë fjalët në gjuhën standarde, madje edhe nuk i kuptojnë ato plotësisht.»
-
- «Problemet kryesore të nxënësve/eve burojnë edhe nga rrethana se ata kanë pak përvojë leximi. Mund të përmenden arsyet vijuese: a) Edhe prindërit lexojnë pak; fëmijët rrallë i shohin ata duke lexuar. b) Fëmijëve nuk u lexohen (ose u lexohen rrallë) tregime. c) Edhe gjatë të qëndruarit në vendin e prejardhjes praktikohet, kryesisht, gjuha e folur.»
-
- «Në përgjithësi motivimi i nxënësve/eve për të lexuarit është i ulët. Edhe më i ulët është në raport me të lexuarit në gjuhën amtare, sepse me të ata kanë edhe më shumë vështirësi.»
-

Kompetenca në të lexuar (si edhe kompetencat në të shkruarit dhe shumë teknika dhe strategji mësimore) nuk janë të lidhura me një gjuhë të caktuar. Kush i ka mësuar ato në një gjuhë, mund t'i transferojë mirë edhe në gjuhët e tjera të tij dhe t'i përdorë ato. Për këtë arsye ndihmesa e MGJP në fushën e të lexuarit në gjuhën e parë, është e dobishme për nxënësit/et edhe në shkollimin e përditshëm të rregullt. Njëkohësisht do të ishte veçanërisht e dëshirueshme, që MGJP dhe mësimi i rregullt për sa i përket zhvillimit të kompetencës së të lexuarit dhe kënaqësisë që ngjall kjo, mundësisht të bashkëpunojnë sa më ngushtë. Edhe kjo është shtruar në pyetjet e anketës sonë:

-
- «Nxënësit/et, të cilët flasin rrjedhshëm në gjuhën shkollore, e bëjnë këtë më mirë edhe në gjuhën e parë. Kompetencat në të lexuar janë gjuhësisht të transferueshme.»
-
- «Të lexuarit është një teknikë e cila duhet të ushtrohet. Kush e zotëron këtë teknikë në një gjuhë, mund ta përdorë atë për secilën gjuhë tjetër. Dhe: Nëse një fëmijë lexon me dëshirë, lexon me dëshirë në të gjitha gjuhët. (...) Është me rëndësi që të lexuarit global, i qëllimshëm dhe i qartë, të lidhet me të gjitha gjuhët, të provohet në të gjitha gjuhët. Për mësimdhënësit dhe nxënësit/et duhet të jetë e qartë që shumicën e strategjive të të lexuarit dhe teknikat e të lexuarit, mund t'i përdorin në të gjitha gjuhët.»
-
- «Do të ishte me shumë përparësi një bashkëpunim i ngushtë mes mësuesve/eve të MGJP dhe atyre të mësimin të rregullt. Nëpërmjet kësaj, të dy palët do të mund të punojnë në mënyrë konkrete edhe të frytshme në përkrahjen e nxënësve/eve në fushën e të lexuarit.»
-

2. Qëllimet dhe ndërtimi i kësaj fletoreje

Të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhën e parë nuk janë aftësi të çfarëdoshme, të cilat mund të lihen anash në mërgim. Aftësimi i nxënësve/eve për të mbledhur dhe përpunuar informacione me shkrim në gjuhën e tyre të parë, është një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e tyre tërësor dygjuhësor-dyletrar. Për më tepër, zotërimi i sigurtë i gjuhës së parë e përkrah edhe mësimin e aftësive letrare në gjuhën shkollore të vendit pritës. Pra, kjo është, si një kompetencë shumë e lartë e ndikimit përzgjedhës, po edhe bazë për suksesin shkollor në mësimin e rregullt.

Kjo fletore do t'i përkrahë mësimdhënësit në detyrën e tyre të rëndësishme, që tek nxënësit/et e tyre të zhvillojnë dëshirën për të lexuarit në gjuhën e prejardhjes dhe ta përkrahin atë. Njëkohësisht kjo fletore do të tregojë rrugët, se si mësimdhënësit e MGJP mund t'i përkrahin nxënësit në mënyrë të qëllimshme në fushat e ndryshme të kompetencës në të lexuar, si për shembull tek të lexuarit e rrjedhshëm, kuptimi i tekstit ose kënaqësia për tekstet e krijuara.

Në pjesën hyrëse, fletorja paraqet një vështrim të shqetësimeve dhe përparësive të didaktikës aktuale të të lexuarit dhe trajton disa çështje specifike, të cilat janë me rëndësi për MGJP. Pjesa e dytë, praktike, përfshin 30 propozime konkrete për fushat, si p.sh. përkrahja e të lexuarit, ushtrimi në të lexuar dhe arsimimi letrar-kulturor. Këtu bëhet fjalë për nxitjet për mësimdhënësit. Ato mund të zhvillohen të shumtën e herës pa e ngarkuar shumë mësimin në aspektin kohor dhe në bazë të materialeve për lexim, të cilat edhe ashtu janë duke u trajtuar. Shumica e nxitjeve janë të përshtatshme – me përshtatjet specifike për moshën – për nxënësit/et e moshave të ndryshme. Kjo përputhet me rrethanat e MGJP, ku nxënësit/et e niveleve të ndryshme mësojnë bashkërisht.

3. Pikat kryesore të didaktikës aktuale të të lexuarit

Të lexuarit nuk mësohet nga sot e deri nesër. Rruga nga zberthimi i shkronjave të veçanta e deri tek të lexuarit e rrjedhshëm të një libri të tërë është e gjatë. Bëhet fjalë për një proces tek i cili shumica e fëmijëve dhe e të rinjve duan të shoqërohen dhe të mbështeten vazhdimisht. Të rëndësishëm në këtë proces janë të rriturit – prindërit dhe mësimdhënësit – shtresa që merr pjesë në interesat e nxënësve/eve në të lexuar, shpesh krejt të ndryshme, e që janë të rëndësishme dhe me të cilët nxënësit/et mund të shkëmbejnë mendime mbi përmbajtjen e librave. Kjo mund dhe duhet të nisë para fillimit të shkollës: nëse prindërit tashmë me fëmijët e tyre krejt të vegjël shikojnë libra të ilu-

struar dhe i komentojnë, ose u lexojnë atyre tregime dhe diskutojnë për to, kjo paraqet një formë veçanërisht të frytshme të përkrahjes së hershme në të lexuar. Nëse u besojmë raporteve të përvojave të lexueseve dhe lexuesve, atëherë ekziston tek të rinjtë përkrahja efektive shkollore në të lexuar tek një mësimdhënës/e, që vetë njihet si lexues/e, që interesohet për parapëlqimet në të lexuar dhe të lexuarit tek nxënësit/et, që njeh shumë libra të ndryshëm dhe të cilët i pëlqen që me nxënësit të inicojë dhe moderojë diskutimet stimuluuese mbi librat e lexuar.

Të lexosh me kënaqësi dhe të lexosh mirë - të dyja këto aspekte janë parakushte të rëndësishme për zhvillimin e suksesshëm të të lexuarit dhe gjithashtu janë të lidhura njëra me tjetrën: vetëm kush e ka gjetur kënaqësinë për tekstet dhe për atë çka tregohet në to, do të bëjë më tutje hapa të tjerë, të mundimshëm. Dhe e kundërta, nxënëset dhe nxënësit duhet të kenë disa aftësi në trajtimin e teksteve, ilustrimeve dhe përmbajtjeve, në mënyrë që të vazhdojnë me qejf dhe të jenë kureshtarë për lexime të tjera.

Mësimi në të lexuarit e përkrahur duhet t'i ketë parasysh pjesët e ndryshme të fushave të të lexuarit. Këtu lënë të dallohen tri fusha: përkrahja e të lexuarit, ushtrimi në të lexuar dhe arsimimi letrar-kulturor. Këto tri fusha plotësojnë njëra-tjetrën, por kompetencat e nevojshme për to shpesh nuk mund të ushtrohen njëkohësisht në të njëjtin tekst. Kjo vlen, natyrisht, edhe për mësimin dhe të lexuarit në gjuhën e prejardhjes. Por fushat individuale mund të ushtrohen dhe të përkrahën në mënyra të ndryshme, me tekste dhe detyra të ndryshme. Kjo ndikon pozitivisht për përvetësimin letrar në gjuhën e parë, si dhe në gjuhën e vendit pritës. Kjo fletore përmban një përmbledhje të ideve dhe të detyrave të gatshme për të tria fushat.

a) Përkrahja e të lexuarit

Qëllimi i përkrahjes së të lexuarit është që nxënëset dhe nxënësit t'i aftësojmë për të lexuarit. Ata duhet të jenë kureshtarë për tekstet dhe librat, duhet të kenë mundësinë të zgjedhin sipas shijes individuale, ata duhet të dinë se si librat dhe tekstet e tjera janë të shumëllojshme dhe sa emocionuese mund të jetë kur përmbajtjet shtjellohen përmes të lexuarit. Objektivi do të ishte që të lexuarit për nxënësit/et të bëhet një veprimtari e vetëkuptueshme dhe e përditshme – si në shkollë ashtu edhe në shtëpi, si në gjuhën e parë, ashtu edhe në gjuhën e shkollës.

Me rëndësi në lidhje me këtë qëllim është përzgjedhja e mirë dhe stimuluuese e teksteve, në mënyrë që mundësisht të gjithë nxënësit/et të gjejnë një lekturë, e cila u intereson dhe në të cilën dëshirojnë të thellohen. Në kuptim të një përzgjedhjeje të pasur përfshihen jo vetëm libra, por edhe revista, gazeta, comics, libra të ilustruar me fotografi dhe, natyrisht, një gamë e tërë tekstesh elektronike – nga faqet e internetit, me informacione për tema faktike e deri të chat forum dhe tek e-book-u.

Tek nxënësit/et, të cilët kanë pak motivim në të lexuar, herë pas here duhet të kërkohet qartë qetësia e nevojshme gjatë të lexuarit. Edhe këta fëmijë dhe të rinj duhet të ulen në vendin e tyre, në qetësi, për t'i lexuar librat apo tekstet e tyre dhe duhet të japin llogari se çfarë dhe sa kanë lexuar. Vetëm kështu ushtrohet një këmbëngulje e ndërgjegjshme dhe do të mënjanohet ndërprerja e librit, të cilin e kanë zgjedhur vetë.

Tek një mësim i leximit përkrahës bën pjesë edhe ajo që nxënëset dhe nxënësit t'i përceptojnë kujdestarët e rritur dhe bashkëmoshatarët e tyre si lexuese e lexues dhe të shkëmbejnë me ta përmbajtjet dhe përvojat e tyre në të lexuar, në mënyrë të ndërsjellë. Në klasat me grupmosha ose grupe të ndryshme, nxënësit/et më të moshuar, mund të luajnë rol të rëndësishëm me shembullin në të lexuar.

Përkrahja në të lexuar ndjek para së gjithash qëllimet vijuese:

- Ajo duhet, në rend të parë, të zgjojë interesimin për librat dhe për mediat e tjera me shkrim dhe me fotografi.
- Ajo duhet që marrëdhënien me ofertat e mëdha të teksteve ta bëjë zakon, për të siguruar një marrëdhënie kompetente, por edhe për të ofruar ndihmën dhe strategjitë në të mësuar.
- Ajo duhet që të hapë të gjitha rrugët për tek fusha e shkrimit dhe të tregojë që leximi mund të jetë një aktivitet me rëndësi të menjëhershme praktike dhe me shumë pikëmbështetje në botën e tyre individuale (Tekste për interesat personale, mediat e ndryshme për temën e njëjtë, përdorimi i teksteve nga gjuha e parë dhe e dytë etj.). Me këtë mund (dhe duhet) të afrohen e të motivohen edhe lexuesit/et e rinj.
- Përkrahja në të lexuar duhet të çojë përfundimisht tek ajo që fëmijët dhe të rinjtë të lexojnë me kënaqësi, që ata të marrin tekste e libra jo vetëm në shkollë, por që të lexuarit dhe marrëdhënia me tekstet në gjuhën e parë dhe të dytë t'i përkasin natyrshëm jetës së tyre të përditshme.

b) Ushtrimi në të lexuar

Me një ushtrim të mirë në të lexuar do të ushtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë të lexuarit e rrjedhshëm dhe të kuptueshëm. Të mund të lexosh mirë dhe rrjedhshëm si dhe të kuptosh të lexuarit, është detyrë e kërkesave të larta. Shumë fëmijë e të rinj – para së gjithash ata me familje me arsimim të paktë – janë shpesh të mbingarkuar në këtë fushë, nëse nuk përkrahen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për këtë arsye, mësimi të të lexuarit përkrahës, i përket ushtrimit i formave të ndryshme të të lexuarit, në të gjitha nivelet e klasave. Në qendër të këtij mësimi janë ushtrimet për shkathtësitë në të lexuar (shkathtësitë bazë), për të lexuarit e rrjedhshëm (saktësia në të lexuar dhe rutina), si dhe strategjitë në të lexuar (ndihmat, se si mund të kuptohen më mirë tekstet e vështira).

Tek ushtrimi në të lexuar nuk qëndron në plan të parë dëshira për të lexuar. Shumë më tepër këtu, para së gjithash, bëhet fjalë që nxënësit/et të ushtrojnë dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre në të lexuar.

Në didaktikën e të lexuarit theksohen tri fusha qendrore të të ushtuarit, të cilat vlejné natyrisht edhe për ushtrimin e të lexuarit në gjuhën e parë:

1. Shkathtësitë në të lexuar

Në këtë fushë bëhet fjalë më shumë për mundësitë teknike në të lexuar të shkronjave-, fjalëve- dhe të fjalive. Shumë nxënës/e – kryesisht më të rinjtë – janë ende pak të sigurtë tek deshifrimi. Ata kanë probleme tek njohja e shkrimit në gjuhën e prejardhjes, tek njohja e fjalëve dhe te lidhjet e pjesëve të fjalisë dhe fjalive. Kjo shfaqet para se gjithash nëse sistemi i shkronjave dhe i shenjave ndryshon nga ai i gjuhës së shkollës (shih për këtë edhe më sipër). MGJP mund të ofrojë shumë përkrahje me një hyrje të kujdesshme në shkrimin dhe shenjat e veçanta të gjuhës së vet, por edhe nëpërmjet punës sistematike në leksik dhe nëpërmjet përjasjes me strukturat komplekse sintaksore.

2. Rrjedhshmëria në të lexuar

Fusha e ushtrimit të fluency (rrjedhshmëria, zhdërvjelltësia) në praktikën shkollore nuk është futur pothuajse fare. Kjo nuk është e drejtë, ngase është me rëndësi të konsiderueshme. Kush lexon me rutinë dhe përmes një teksti «kalon» relativisht shpejt e pa gabime, ka gjithashtu më pak vështirësi për ta kuptuar përmbajtjen. Arsyeja qëndron në atë se lexuesit/et e ushtuar përqëndrohen më mirë në të kuptuarit e përmbajtjes, sepse pjesa teknike e procesit të të lexuarit tek ata është gjerësisht e automatizuar. Nga ana tjetër, lexuesit/et me fluency ose zhdërvjelltësi të dobët duhet të investojnë një pjesë të energjisë së tyre për deshifrimin dhe aspektet e tjera teknike të pro-

cesit të të mësuarit. Të dhënat e reja nga Gjermania tregojnë gjithashtu se shumë nxënës/e gjatë ushtrimit të zhërvjelltësisë mund të ndërtonin një koncept të ri ose koncept personal rrënjësor në raport me aktivitetin e tyre si lexues/e. Ata, pas përfundimit të kësaj faze të ushtrimit, ndiheshin më kompetentë dhe e quanin veten më shpesh si lexues ose lexues të mirë dhe të motivuar. Kjo çon përsëri tek një motivim më i lartë në të lexuar. Në thelb është një e vërtetë e përgjithshme: kush lexon mirë, lexon me dëshirë. Kush lexon me dëshirë, lexon shumë. Kush lexon shumë, lexon mirë.

3. Strategjitë e të lexuarit

Lexueset dhe lexuesit e mirë e të ushtruar e dinë se çfarë mund të bëjnë për ta kuptuar një tekst mundësisht shpejt dhe saktë. Ata përdorin (shpesh në mënyrë të pavetëdijshme) strategji të ndryshme për zbrëthimin e tekstit dhe nuk e lexojnë thjesht sipas rastësisë. P.sh., ata bëjnë një lloj plani të leximit dhe e lexojnë tekstin sipas këtij plani dhe qëllimeve të tij në mënyra e forma të ndryshme. Në fushën e didaktikës dallohen tri mënyra të leximit dhe të kuptimit të të lexuarit, të cilat duhet të praktikohen vetëdijshëm në shkollë - dhe natyrisht edhe në MGJP – në bazë të teksteve të përshtatshme:

- Të lexuarit e *qëllimshëm*: Këtu bëhet fjalë për kërkimin me qëllim të caktuar për një informacion specifik, p.sh. në fjalor ose në librin e numrave telefonikë, në orarin e udhëtimit ose në një tekst me përmbajtje faktike.
- Të kuptuarit e të lexuarit *global*: Qëllimi këtu është që të kapet thelbi i një teksti, pa e memorizuar me çdo kusht çdo detaj. Kjo mënyrë e të lexuarit është veçanërisht e shpeshtë p.sh. në lidhje me tekstet letrare ose me artikujt e gazetave.
- Të kuptuarit e të lexuarit të *detajuar*: Këtu është me përparësi që të mund të kuptohet çdo detaj tek një tekst (p.sh. tek një recetë ose te një udhëzues apo para një provimi).

Lexuesit/et e ushtruar e mbikëqyrin vazhdimisht procesin e të kuptuarit gjatë të lexuarit të lekturës dhe e dinë ku të kërkojnë ndihmë në rast vështirësie. Njohja dhe përdorimi i pavarur i strategjive të të lexuarit është një aspekt thelbësor i kompetencës në të lexuar. Në të vërtetë, dhënia e kësaj strategjie ndodh më së miri në bazë të përpunimit të teksteve në mësim, p.sh. në kuadër të një bisede të zhvilluar mësimore. Pastaj është e vetëkuptueshme që duhet të bëhet zbatimi i kujdesshëm i strategjive dhe ato duhet të ushtrohen vazhdimisht derisa të përvetësohen nga nxënësit/et. Në varësi të formës dhe përmbajtjes së tekstit duhet të vepohet ndryshe, duke zbatuar strategji të tjera

(p.sh. të tilla për të kuptuar dhe vlerësuar tekstet faktike, për të përmbledhur tregimet, për të kuptuar grafikën etj.) Materiale dhe udhëzime për këtë ofron edhe broshura «Materiale didaktike 5: Dhënia e strategjive dhe teknikave mësimore në MGJP», ku në kapitujt 2 dhe 3 gjenden strategji të tjera për përdorimin e mjeteve ndihmëse (fjalorë, libra këshillues etj.) në të lexuar.

Për të tri fushat: shkathtësitë në të lexuar, rrjedhshmëria në të lexuar dhe strategjitë në të lexuar, do të paraqiten në këtë broshurë ushtrime të shumëllojshme dhe shembuj, të cilët natyrisht duhet t'u përshtaten parakushteve të klasës apo grupit përkatës. Lexuesit/et e dobët duhet t'i përpunojnë mundësisht sa më shumë ushtrimet në fushën e shkathtësive në të lexuar. Lexuesit/et e fortë mund t'i mënjanojnë ushtrimet e shkathtësive dhe ta përdorin kohën për leximin e tyre personal. Për ushtrimin e rrjedhshmërisë dhe strategjive në të lexuar është veçanërisht e dobishme, nëse përdoren përmbajtje me temë nga jeta e përditshme.

c) Arsimiti letrarokulturor

Arsimimi letrarokulturor ka për qëllim që nxënësit/et të fitojnë përvoja me tekstet (letrare) krijuese. Kjo ka të bëjë, p.sh. me përdorimin me kënaqësi dhe nëpërmjet lojës të gjuhës tek poezitë dhe lojërat gjuhësore ose kënaqësia për tekstet letrare të krijuara. Natyrisht në MGJP janë parësore tekstet nga gjuha e prejardhjes për dhënie të njohurive themelore, sipas moshës, për historinë e letërsisë së tyre. Nëse në klasët e larta mund të bëhen referenca me literaturën e vendit pritës ose të literaturës botërore, atëherë kjo e zgjeron horizontin letrar.

Qëllimi kryesor për nxënësit/et është zhvillimi i një ndjeshmërie estetike, e cila është e dobishme për përvojat e reja me tekstet krijuese poetike. Kultura e një vendi dhe populli pasqyrohet në fusha të gjera në tekste dhe libra. Kjo vlen për përrallat dhe legjendat e trashëguara, si dhe për poezitë dhe tregimet ose romanet bashkëkohore. Të gjitha këto gjini, në raport me gjuhën, i plotësojnë kriteret e caktuara përmbajtësore dhe formale, të cilat dallohen qartë prej atyre të përditshmërisë ose prej teksteve faktike. Këto dallime, natyrisht mund të tematizohen me nxënësit/et më të moshuar. Por, në radhë të parë, nuk bëhet fjalë për t'i analizuar tekstet letrare, por mbi të gjitha thjesht të njihen, të mund të përjetohen dhe të mësohen me to hap pas hapi.

Rimat, vargjet dhe ritmet gjuhësore, por edhe situatat e të lexuarit mundësojnë edhe tek fëmijët shumë të vegjël përvoja intensive, ndijimore-estetike të të dëgjuarit. Kush ka fituar përvoja të tilla të të dëgjuarit, do të dëgjojë me «veshin e brendshëm» edhe tek të lexuarit e mëvonshëm të literaturës në qetësi. Tek tekstet lirike kjo është me rëndësi të veçantë.

Me përkrahjen e mësimdhënësit dhe në bazë të dhënies së detyrave të përshtatshme, të lexuarit në bashkësinë e klasës mund të jetë bazë, që gjuha e krijuar – p.sh. një poezi ose një tregim – jo vetëm të përjetohet, por edhe të kuptohet gjithashtu në nivele të ndryshme. Gjatë shkëmbimit të ndërsjellë do të plotësohen zbrazëtitë në të kuptuar, dhe ajo që qëndron mes rreshtave, do të silllet në vetëdije dhe në gjuhë. Bashkërisht do të imagjinohen pamje ose do të ripërsëriten skenat (ripërsëritja është një formë e shkëlqyer e kontrollit të të kuptuarit dhe e thellimit të të kuptuarit). Karakteret dhe mënyra e të vepruarit të figurave të veçanta mund të interpretohen dhe të diskutohen dhe bashkërisht mund të tematizohet se çfarë ndiejmë tek leximi i një teksti letrar të krijuar. Të pasqyruarit e përbashkët, diskutimi dhe përpunimi u ndihmon nxënësve/eve që ta kuptojnë vërtet brendinë e një teksti. Është pa diskutim më produktive, tërheqëse dhe komunikuese sesa të menduarit në qetësi ose detyra klasike si «Shkruaj si dhe pse të ka pëlqyer teksti».

4. Pika shtesë me lidhje të veçantë me të lexuarit në mësimin në gjuhën e prejdardhjes

Të lexuarit dhe përkrahja e të lexuarit në MGJP dallohet, ashtu siç u shpjegua më lart, kryesisht në lidhje me gjuhën e teksteve dhe prejdardhjes së tyre kulturore, nga mësimi në të lexuar në klasën e rregullt. Megjithatë, fushat e punës dhe të ushtrimit janë kryesisht identike dhe, për këtë arsye, të tilla janë edhe qëllimet e shoqërizimit letrar dhe përkrahja në gjuhën e parë dhe të dytë. Pjesët vijuese a) dhe b) edhe janë menduar më pak si specifike për MGJP, shumë më tepër nxjerrin në pah përgjithësisht dy pika parimisht të rëndësishme (dhe me këtë edhe për MGJP).

a) Lehtësimi i teksteve para të lexuarit

Leksikut i jepet rëndësi e madhe gjatë të lexuarit. Shpesh, lexuesit/et nuk e kuptojnë një tekst sepse ai përmban shumë fjalë të panjohura. Në tekstet që janë shkruar në variantin e standardit, kjo mund të çojë tek problemet e veçanta, sepse shumë fëmijë dhe të rinj e praktikojnë gjuhën e parë në shtëpi vetëm në dialekt.

Për këtë arsye shpesh është e rëndësishme, që tekstet paraprakisht të thjeshtësohen gjuhësisht, për ta lehtësuar qasjen në to. Një metodë e provuar për këtë është që, para se të lexohet, të shikohen bashkë me nxënësit/et një listë e fjalëve çelës dhe eventualisht fjalët e panjohura dhe të sqarohen vështirësitë («Shiko, ne e lexojmë tash një tekst, në të cilin paraqiten fjalët ,ledhe’, ,u gjet’, ,rrëqethës’, dhe ,armatimi i kalorësve’. Këto duam t’i sqarojmë së pari!»). Nga kjo nxënësit/et mund të përgatiten jo vetëm për përmbajtjen e tekstit, por ata i aktivizojnë shumë më tepër njohuritë e tyre

paraprake, krijojnë hipoteza dhe i kuptojnë një pjesë të madhe të formave dhe kuptimeve që paraqiten në tekstin e gjuhës standarde. Të kuptuarit mund ta lehtësojnë edhe fotografitë, të cilat e ilustrjnë ngjarjen, tregojnë detaje, pasqyrojnë përshtatshmëritë ose përmbajtjet faktike duke i paraqitur dhe duke i sqaruar nëpërmjet ilustrimeve.

b) Nuk duhet që përherë të kuptohet çdo fjalë

Shpesh lexueset dhe lexuesit (edhe mësuesit/et!) përqëndrohen fort në atë që nuk e kanë kuptuar, në vend që, së pari, të përqëndrohen në atë çfarë kuptohet plotësisht. Ky vështrim i orientimit deficitar mund të ndikojë në mënyrë shkurajuese.

Por ka edhe një mënyrë tjetër: Për shembull, nëse nxënësit/et e marrin për detyrë që të nënvizojnë gjithçka që kanë kuptuar. Nëpërmjet shenjimit të vendeve, të cilat i kanë kuptuar menjëherë, atyre u bëhet e kuptueshme se, në parim, janë vetëm disa pjesë të një fjalie ose fjale të veçanta, të cilat nuk i kuptojnë gjatë të lexuarit. Me këtë, në të shumtën e rasteve, rritet edhe motivimi për të lexuar edhe më tutje. Në kontekst të asaj që kemi kuptuar mund të zgjidhen shumë shpesh edhe problemet e tjera të të kuptuarit.

Tek disa tekste lexuesit/et nuk duhet patjetër t’i kuptojnë të gjitha fjalët; varësisht nga qëllimi i mësimin dhe formës së tekstit mjafton një kuptim i përgjithshëm global (shih më lart). Mund të jetë ndihmuese, nëse fjalët-çelës dhe pjesët qendrore në tekst nënvizohen paraprakisht. Kështu lexuesit e dinë, se ku duhet të kenë kujdes dhe cilat pjesë meritojnë vëmendje të veçantë. Në varësi nga qëllimet, të cilat lidhen me tekstin përkatës (si për shembull a duhet të ketë një përjasje të detajuar me përmbajtjen dhe mesazhin), duhet të pasojë në vazhdim puna e thelluar me leksikun. Pra, është e qartë se puna në leksik në kontekst të teksteve reale është veçanërisht autentike dhe e frytshme.

c) Bashkëpunimi me mësimin e rregullt

Nëse MGJP dhe mësimi i rregullt bashkëpunojnë, ky kooperim e zgjeron horizontin dhe e thellon qëndrueshmërinë e të mësuarit. Kjo nuk vlen vetëm për përmbajtjet e trajtuara bashkërisht (p.sh. uji ose bujqësia në vendet e ndryshme), por edhe për shumë teknika dhe strategji mësimore. Këto, duke qenë gati gjithnjë mbigjuhësore, gjegjësisht mund të përdoren në gjuhë të ndryshme dhe një bashkëpunim mes mësimdhënësve të MGJP dhe atyre të klasëve të rregullta në këtë fushë është veçanërisht i vlefshëm. Kjo vlen edhe për fushën e rëndësishme të arsimimit letrar-kulturor, në të cilën MGJP dhe mësimi i rregullt e plotësojnë njëri-tjetrin në mënyrë optimale dhe mund ta përkrahin bashkërisht kënaqësinë në të lexuar.

Aty ku kontaktet institucionale mes MGJP dhe mësimit të rregullt nuk janë automatikisht të dhëna (si p.sh. në Suedi), nganjëherë mbetet kryesisht në vullnetin e mësuesve/eve të MGJP që të marrin kontakt dhe të informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit në fushën e të lexuarit. Disa ide për këtë (krh. edhe shumë propozime në pjesën e dytë të kësaj broshure!):

- Të lexohen poezi në gjuhët e ndryshme (dhe/ose të shkruhen vetë); të mësohet si të paraqiten, incizimi i një cd-me poezi, krijimi i një libërthi shumëgjuhësor; përkthimi në gjuhën e shkollës. Eventualisht edhe tubim me prindërit me recitime shumëgjuhësore.
- Leximi i përbashkët i një-ose dy librave të botuar ose të librave të ilustruar.
- Përgatitja e një ekspozite me libra në gjuhë të ndryshme; secili libër do të përshkruhet shkurtimisht në një fletë.
- Përdorimi i burimeve elektronike ose të tjera nga gjuhët e ndryshme për një temë të përbashkët nga fusha faktike (p.sh. periudha romake në Gjermani dhe në Turqi etj.).
- Zbatimi i përbashkët dhe përdorimi i strategjive-ose të teknikave të caktuara të të lexuarit (shiko pjesën II të kësaj broshure dhe broshurën 5: Teknikat dhe strategjitë mësimore).
- Puna e përbashkët në krijimin e një biblioteke shumëgjuhësore shkollore.
- Bashkëpunimi (seminare etj.) në kuadër të një projekti javor «Kënaqësia në të lexuar në gjuhët e ndryshme» ose në kuadër të një mbrëmjeje leximi.

Nganjëherë nuk krijohen mundësi të bashkëpunimit për arsye të mbingarkesës. Në këto raste ne këshillojmë si zgjidhje minimale që mësuesit/et e MGJP t'i lënë nxënësit që t'i sjellin librat e gjuhës të mësimit të rregullt dhe të shikojnë në to se çfarë gjendet për sa i përket fushës së përkrahjes në të lexuar, ushtrimeve në të lexuar, strategjive në të lexuar dhe arsimimit letrar. Natyrisht që aty ka ide të cilat me siguri mund të futen edhe në MGJP, dhe sigurisht që këtu mund të ndihmojnë nxënësit/et me sqarimet, sugjerimet dhe përvojat e tyre.

d) Ku mund të gjenden tekste në gjuhën e prejardhjes?

- Mbledhja e teksteve për përdorimin në mësim

Se mësuesit/et e MGJP kanë përmbledhje të teksteve të veta për mësimin e tyre, kjo vetëkuptohet. Ato mund të jenë vepra letrare, përmbledhje poezish dhe përrallash, libra të ilustruar ose lektyrë shkollore në gjuhën e prejardhjes, por edhe përmbledhje e artikujve, tregimeve etj. për tema faktike. Gjithnjë e më të rëndësishme po bëhen edhe listat me vjegza për faqet e përshtatshme në internet.

Por përmbledhje të teksteve mund dhe duhet të krijohen edhe me nxënësit/et e MGJP. Një zgjidhje e thjeshtë është sigurisht që të luten nxënësit/et dhe prindërit e tyre e të afërmit që të sjellin materiale për lexim në gjuhën e tyre dhe që t'i japin për shfrytëzim MGJP. Këto mund të jenë libra të ilustruar, libra, revista (për fëmijë) të ilustruara, komike etj. Natyrisht që mund dhe duhet të kërkohet nga dhe me nxënësit/et që të gjenden në internet tekste në gjuhën e prejardhjes dhe të shfrytëzohen ato. Me rëndësi këtu është që mësimitdhënësi t'i përkrahë nxënësit/et dhe t'i ndihmojë ata që të kenë një raport të përgjegjshëm me burimet (të dhëna nga burime serioze; ndihmë për citime etj.)

Me rëndësi: Në varësi nga krahina e prejardhjes dhe konteksti politik, mësimitdhënësi duhet të jetë rreptësisht i kujdesshëm që, gjatë grumbullimit të këtyre teksteve, të mos pranohen tekste me përmbajtje tendencioze, nacionaliste ose me karakter tjetër provokues.

- Përmbledhje e teksteve për huazim

Përmbledhjet e teksteve për përdorim të drejtpërdrejtë në mësim janë të rëndësishme, por ende nuk janë të mjaftueshme. Në kuptim të një përkrahjeje aktive në të lexuar në gjuhën e parë, ato duhet të plotësohen me një sërë librash dhe teksteve të tjera, të cilat nxënësit/et mund t'i huazojnë dhe t'i lexojnë në shtëpi. Në rastin më të mirë, ata do të gjejnë tituj të tillë në një bibliotekë ndërkulturore (për udhëzime shiko më poshtë), ose në bibliotekën e shkollës së tyre, në qoftë se ajo është projektuar të jetë shumëgjuhësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë puna mbetet te mësimitdhënësi i MGJP. Nëse mësimitdhënësi ka një sasi të teksteve dhe e bën për këtë një listë të thjeshtë huazimi (një tabelë me titujt dhe fushat për emrat e huazuesve), kjo do të ishte e mjaftueshme. Çdo javë, nxënësit/et mund të «porosisin» atë që duan për të lexuar dhe të kthejnë librat e lexuar. Sigurisht, edhe vetë nxënësit/et mund të ndihmojnë tek ky kënd i vogël bibliotekë. Një kohë veçanërisht e mirë për këtë janë pushimet verore, të cilat shumë fëmijë i kalojnë në vendin e tyre të prejardhjes, prej ku ata mund të sje-

llin materiale për lexim. Ndoshta, para pushimeve, në kuadër të një aksioni të vogël (treg, tubim i prindërve etj), mund të mblidhen edhe disa të holla, kështu që çdo fëmijë do të ketë një buxhet të vogël për blerjen e librave. Edhe këtu natyrisht nuk duhet të mungojë kontrolli për titujt në aspektin e asnjësisë politike dhe ideologjike.

Për ruajtjen e bibliotekës së vogël, e cila jetësohet në këtë mënyrë, ndoshta mund të gjendet në shkollë edhe një dollap. Më mirë do të ishte natyrisht, në qoftë se biblioteka e vetë shkollës (nëse ka një të tillë), do të përfshijë përmbledhjet në gjuhët e ndryshme të prejardhjes së nxënësve/eve dhe do mund të përdoret edhe nga MGJP. Atje ku MGJP është i integruar mirë në sistemin e rregullt shkollor, kjo nuk do të duhej të sjellë asnjë problem. Por, edhe në raste të tjera, mund të jetë një nismë e tillë nga mësuesit/et e MGJP me siguri e vlefshme.

• Bibliotekat publike ndërkulturore

Shumë biblioteka, veçanërisht në vendet më të mëdha, mbajnë gati për huazim një përzgjedhje të librave (përf. libra të ilustruar, për fëmijë e të rinj) dhe nganjëherë edhe revista në gjuhë të ndryshme.

Në Zvicër ka një shoqatë të këtyre bibliotekave ndërkulturore; shihni faqen e internetit. <http://www.interbiblio.ch> me një pasqyrë të vendeve ku ndodhen dhe mundësitë e huazimit.

Për Suedinë, informacion të plotë gjeni në faqen e internetit <http://modersmal.skolverket.se/sites/svens-ka/index.php/flersprakighet-i-forskolan/kop-lan> të.

Për Gjermaninë krahaso: <http://www.bibliothek-sportal.de/themen/bibliothekskunden/interkulturelle-bibliothek/materialien-in-mehreren-sprachen.html>

- Huazimi i librave dhe informacionet tek institucionet e vendeve të veçanta (shembuj)

Gjermani:

Faqja e internetit e asociacionit të bibliotekave gjermane përmban informacione të plota dhe gjithashtu lejon kërkime të sakta. Aty do të gjeni materiale dhe informacion mbi temat e mëposhtme: tekste për punë të bibliotekës, fjalori multilingual i bibliotekës dhe fjalorë online, dëshmi të materialeve në gjuhë të huaja në bibliotekat publike gjermane, përmbledhje e vjeggzave për gjuhën dhe kulturën, vjeggza për platformat në gjuhë të huaja të Wikipedia-s, vjeggza për mediat, gazetatat dhe revistat, modele tekstesh për masat në fushën e përkrahjes së të shkruarit dhe të lexuarit. Vjeggza: <http://www.bibliothek-sportal.de/> dhe <http://www.bibliothek-sportal.de/themen/bibliothekskunden/interkulturelle-bibliothek/materialien-in-mehreren-sprachen.html>

Informacione të vlefshme për librat shumëgjuhësor, materialet për mësim dhe një përmbledhje shumë të dobishme të vjeggzave për institucionet e tjera ofron vjeggza e Institutit Goethe: <http://www.goethe.de/ges/spa/prj/sog/fms/lit/deindex.htm>

Informacione të rekomandueshme dhe nxitje për përfshirjen e prindërve ofron vjeggza: <http://www.mehrsprachigvorlesen.verband-binationaler.de>

Austria:

Shumë informacione dhe opsione kërkimi mund të gjenden në vjeggzën <http://www.schule-mehrsprachig.at/>. Veçanërisht për libra për fëmijët shumëgjuhësor shih <http://www.schule-mehrsprachig.at/index.php?id=11>. Përveç shumë materialeve, ka gjithashtu edhe një revistë për fëmijë shumëgjuhësor, e cila mund të porositet edhe nga Zvicra dhe Gjermania. Abonimi është falas, llogariten vetëm shpenzimet e transportit. Informata të dobishme ofron edhe faqja austriake e internetit <http://www.wirlesen.org>

Zvicër:

Në Zvicër fondacioni Bibliomedia ka mbledhur një përzgjedhje të pasur të librave në gjuhë të huaja dhe atyre shumëgjuhësorë, të cilat natyrisht edhe mësimdhënësit e MGJP mund t'i huazojnë për një periudhë më të gjatë kohore. Në dispozicion janë libra në shqip, arabisht (libra vetëm për fëmijë), anglisht, kroatisht, portugalisht, spanjisht, serbisht, tamilisht, turqisht. Rreth përzgjedhjes së librave shumëgjuhësorë informacionet gjenden në një listë të internetit. Varësisht nga vendi ku ndodhet shkolla, kostot e huazimit janë të ndryshme. Mësimdhënësit më së miri është që të pyesin udhëheqësinë e shkollës apo të kontaktojnë

drejtpërdrejt Bibliomedia-n. Bibliomedia ofron gjithashtu materiale mësimore, listat e librave, dhe një përmbledhje të vjeggzave aktuale shitesë për temën e shumëgjuhësisë. Vjeggza: www.bibliomedia.ch. Adresa: Bibliomedia, Rosenweg 2, 4500 Solothurn, tel. 032 624 90 20

JUKIBU (Biblioteka ndërkulturore për fëmijë dhe të rinjë): Kjo bibliotekë e veçantë në Basel, ka një ofertë të librave dhe mediave në 50 gjuhë të ndryshme. Një katalog aktual interneti ndihmon në kërkimin e titujve. Në JUKIBU gjithashtu organizohen rregullisht edhe takime të ndryshme. Vjeggza: www.jukibu.ch. Adresa: JUKIBU; Elsässerstrasse 7, 4056 Basel, tel. 061/322 63 19

Baobab: Shoqata Baobab është e angazhuar me tema ndërkulturore të lidhura me leximin dhe boton herë pas here libra shumëgjuhësorë. Vjeggza: <http://www.baobabbooks.ch>.

Rrjeti sims: Në këtë platformë gjenden listat e librave në gjuhë të ndryshme, të cilat mund të porositen. Gjithashtu këtu gjenden shumë materiale të dobishme mësimore për përkrahjen gjuhësore të nxënësve/eve emigrant të cilat janë në dispozicion për shkëmbim: <http://www.netzwerk-sims.ch/>.

Bischi – doracak për bashkëpunimin mes bibliotekës dhe shkollës; botuar nga Drejtoria e Arsimit e Kantonit të Cyrihut. Doracakun ofron nxitje të vlefshme e të nduarnduarshme. Kjo tregon se deri ne çfarë mase bashkëpunimi është më shumë se sa vetëm një huazim. Vjeggza: <http://www.bischi.zh.ch>

Suedi:

Informacione të plota për botuesit, bibliotekat, mundësitë e huazimit etj. mund të gjenden në faqen e internetit tashmë të përmendura më lart: <http://modersmal.skolverket.se/sites/svenska/index.php/flersprakighet-i-forskolan/kop-lan>

Gjithsej: Fondacioni i bibliotekave kombëtare evropiane gjenden vjeggza për partnerët e ndryshëm në Evropë. Vjeggza: <http://www.theeuropeanlibrary.org>.

Pjesa I: Përkrahja e të lexuarit

Ushtrimet dhe propozimet mësimore të kësaj pjese janë ndarë në tri fusha:

Të marrurit me libra dhe tekste

Propozimet mësimore 1–8:

Në plan të parë këtu qëndron njohja me libra dhe tekste të ndryshme si element i rëndësishëm i motivimit në të lexuar.

Librat dhe tekstet të lexohen dhe të kuptohen

Propozimet mësimore 9–11:

Kjo fushë e përqendron të lexuarit në vetvete dhe tregon mundësitë se si mund të bëhet të lexuarit në mënyra të ndryshme dhe se si nxënëset dhe nxënësit mund të planifikojnë procesin e leximit dhe të bëhen të vetëdijshëm për përfitimet prej tij.

Të raportohet për të lexuarit

Propozimet mësimore 12–17:

Kjo pjesë e kësaj fushe merret kryesisht me pasqyrimin e asaj që është lexuar, d.m.th., me diskutimin rreth përmbajtjeve. Ajo ofron disa propozime për mënyrën se si mund të bisedohet në klasë për përvojat në të lexuar.

Të reflektohet të lexuarit

Propozimet mësimore 18–19:

Të dy propozimet mësimore të kësaj rubrike e përkrahin kompetencën e rëndësishme të nxënësve/eve që të mund t'i vlerësojnë vetë aftësitë e tyre dhe të vetëdijësohen për zakonet dhe preferencat në të lexuar. Këto kontribuojnë në atë që nxënësit/et të bëhen lexues/e të pavarur dhe të pasionuar.

1

Të lexosh para të tjerëve si ritual

Qëllimi

Të lexuarit para të tjerëve është njëra prej metodave më të thjeshta dhe njëkohësisht më të efektshme për përkrahjen e motivimit në të lexuar. Tek ky lexim N mund thjesht të kënaqen me tregimet ose me një libër. Ata mësojnë se sa emocionuese mund të jenë tregimet dhe se ia vlen që të mësojnë të lexojnë mirë dhe shpejt.

kl. 1-9

15-20 min.



Materiali:

Libri (si vazhdim) ose përmbledhje e teksteve të shkurtra.

Rrjedha:

Secila njësi e MGJP (p.sh. dyorëshi javor) do të fillojë me një sekuencë të të lexuarit para të tjerëve. N ulen qetësisht dhe M u lexon atyre të paktën 15 minuta nga një libër. Synimi kryesor është të përjetuarit dhe thellimi në një tregim.

Vërejtje:

- Para së gjithash, në qoftë se një libër do të lexohet para të tjerëve (dhe jo tregime të shkurtra, të veçanta), është e rëndësishme që ky ritual të zhvillohet për një periudhë më të gjatë kohore dhe pa ndërprerje, ngase në të kundërtën N do të humbin fillin e librit.
- Në MGJP janë shpesh të pranishën N të klasave të ndryshme në të njëjtën kohë. Në mënyrë që të ndihen të gjithë të përfshirë duhet të zgjidhet një tekst për t'u lexuar para të tjerëve, i cili mundësisht t'u përshtatet të gjitha grupmoshave. Alternativat: tekste të shkurtra shkëmbyese më tepër për nivelin e ulët, të mesëm dhe nivelin e lartë.
- Gjatë një sekuence të leximit para të tjerëve duhet të mbizotërojë qetësia në klasë. Ndoshta N mund të vizatojnë diçka paralelisht, megjithatë, nuk lejohet asgjë që krijon zhurmë dhe mund të sjellë shpërqëndrim.

Variantet:

1. N mund të bashkëvendosin se çfarë do të lexohet para të tjerëve. M vë në shfrytëzim për këtë një përzgjedhje të teksteve të gatshme. Natyrisht edhe N mund të sjellin tekste për lexim para të tjerëve.

2. Nuk është e thënë që gjithnjë M të jetë ai i cili lexon para të tjerëve libra apo tregime, edhe N mund të marrin përsipër këtë rol. Por, është me rëndësi, që të lexuarit para të tjerëve të ushtrohet paraprakisht në mënyrë intensive. Është e dobishme që tekstet një javë më përpara t'u jepen N që t'i marrin në shtëpi dhe që ata t'i ushtrojnë tekstet. (Shih për këtë edhe ndihmesën për të lexuarit personal para të tjerëve në faqen 38.)

3. Teksti i lexuar para të tjerëve përherë do të incizohet në magnetofon ose nëpërmjet mediave të tjera (diktafon, celular, kompjuter). Libri dëgjimor i krijuar kështu, natyrisht mund të huazohet; gjithashtu, kopjet mund t'i jepen në shfrytëzim edhe një klase tjetër. Variante: N e vjetër e deklamojnë për të rinjtë një libër në një magnetofon. Krahaso këtu edhe propozimin mësimor 10 «Të lexuarit para të tjerëve të incizohet në magnetofon për të tjerët».

2

Të hapet një bibliotekë e vogël në gjuhën e parë

Qëllimi

N njohin një listë të gjerë dhe stimuluere të teksteve në gjuhën e tyre të parë. Ata shkëmbejnë informacion në lidhje me leximet e bëra (ose për librat e ilustruar) dhe mund të zgjedhin nga librat e ndryshëm. Ata do të mësohen me rregullat e një biblioteke.

kl. 1-9

10-20 min.



Materiali:

Libra të ndryshëm, libra të ilustruar, komedi, revista të ilustruara dhe revista për të rinj në gjuhën e tyre të parë.

Rrjedha:

- Projekti fillon si një projekt i përbashkët: Ne duam të krijojmë një bibliotekë të vogël me një shumëllojshmëri të gjerë tekstesh (libra, libra me fotografi, libra reference etj) në gjuhën tonë. Duhet të sqarohet: Kush mund të sjellë diçka? Ku duhet të ruhen librat dhe tekstet e tjera (ka ndoshta një dollap në shkollë ose një raft në bibliotekën e shkollës për këtë)? Si duhet të funksionojë huazimi?
- N sjellin nga shtëpia materiale të ndryshme për lexim dhe i paraqesin ato para klasës. Më pas, të gjithë titujt do të renditen (p.sh. në formën e një table të thjeshtë huazimi) dhe, nëse është e mundshme, vendosen në një raft.
- N mund t'i japin njëri-tjetrit në mënyrë të ndërsjelltë këshilla për lexim dhe të huazojnë libra dhe revista. Për këtë mund të parashikohen çdo javë 10 minuta. Në tabelën e huazimit do të shënohet kush dhe çfarë libri merr. Do të përcaktohen p.sh. dy N për një tremujor, të cilët do të marrin përsipër kontrollin dhe janë përgjegjës për të siguruar që të gjithë librat e huazuar do të kthehen në gjendje të mirë.



Vërejtje:

- Ashtu siç është theksuar në hyrje, tek kapitulli 4d N mund të inkurajohen që të sjellin tekste kur të shkojnë për pushimet e gjata në atdhe (për ta financuar këtë, ndoshta, mund të organizohet paraprakisht një pazar në kuadër të një tubimi të prindërve, që të grumbullohen pak të holla).
- Është e rëndësishme që, në bibliotekën e vogël të MGJP, të gjenden lektyra për të gjitha grupmoshat, ndonjë enciklopedi për fëmijë dhe të rinj dhe një fjalor.
- Biblioteka mund të përfshijë edhe libra audio, qoftë të blerë apo të bërë vetë (krahaso këtu propozimin e mësimi 1 dhe 10).

3

Huazimi i librave tek institucionet si «Bibliomedia»

Qëllimi

N duhet të gjejnë materiale për lexim në gjuhën e tyre të parë, të cilat u interesojnë, kështu që nëpërmjet kësaj do të duhej të rritet motivimi dhe kompetenca në të lexuar. Në përzgjedhjen e lekturës së përshtatshme për lexim ata mund të shfrytëzojnë ofertat e institucioneve të specializuara, si p.sh. «Bibliomedia» në Zvicër. Institucione të tilla ku mund të huazohen libra në gjuhë të ndryshme për një kohë të gjatë, ka në shumë shtete.

kl. 1–9

15–30 min.



Rrjedha:

- Oferta, të cilën e ka institucioni përkatës për gjuhën e vet të parë, do të shikohet dhe diskutohet bashkërisht. Do të bëhet përzgjedhja dhe do të jepet porosia.
- Pas pranimit të librave N mund t'i marrin ata në shtëpi për t'i lexuar. Gjatë 4–6 javëve do të rezervohen nga 15–30 minuta në MGJP, gjatë të cilave N do të do të shkëmbejnë përvojat e tyre të leximit dhe do të japin rekomandimet.
- Do të përcaktohen dy N që do të marrin kontrollin dhe do të kujdesen që të gjithë librat e huazuar do të kthehen në gjendje të mirë dhe të pastër.

Vërejtje:

- Gjatë kërkimit për institucione të përshtatshme, mund të ndihmojnë bibliotekari vendor / bibliotekarja vendore ose mësimdhënësi kompetent në shkollë.
- Informacionet mbi vjeggzat në institucionet e ndryshme në Gjermani, Austri, Suedi dhe Zvicër mund të gjendet në hyrje të Kap. 4d, «Huazimi i librave dhe informacione mbi institucionet e veçanta vendore.»

4

Vizita në bibliotekë

Qëllimi

N vizitojnë një bibliotekë (nëse është e mundshme shumëgjuhësore) dhe e përjetojnë atje se sa e larmishme është oferta. Ata do të mësojnë atje për fondin e librave dhe ndërtimin e bibliotekës dhe do të informohen për kushtet e huazimit. Ata do të duhej të shohin bibliotekën edhe si një vend mësimi, d.m.th., si një pikë qendrore, ku ata mund të marrin informacione mbi tema të veçanta.

kl. 1–9

45–90 min.



Rrjedha:

- Shumica e bibliotekave janë shumë të gatshme për t'i pritur klasat e shkollave dhe për t'i udhëhequr ato nëpër mjediset e bibliotekës. Shumë biblioteka, veçanërisht ato më të mëdhatë, i mbajnë të gatshme për huazim librat në gjuhë të ndryshme.
- Hyrja në bibliotekë duhet të bëhet një zakon i rëndomtë për të gjithë nxënësit/et. Në bibliotekë ata do të gjejnë ato libra, të cilat vërtet u interesojnë. Ata mund të jenë me tema shumë të ndryshme si libra gatimi, revista rreth futbollit, histori dashurie apo komike. Shpesh në bibliotekë janë në dispozicion edhe kompjuterët me anën e të cilëve mund të kërkohen tekstet në gjuhën e parë.

Vërejtje:

- Për bibliotekat ndërkulturore dhe për bibliotekat e zgjeruara shumëgjuhësore të shkollave, krahaso kap. 4D në hyrje. Zgjerimi i bibliotekës shumëgjuhësore të një shkolle është një projekt i përbashkët optimal i MGJP- dhe mësuesve të klasave të rregullta; krahaso për këtë kap. 4c.
- Do të ishte ideale në qoftë se vizita në bibliotekë do të mund të zhvillohet në një bibliotekë shumëgjuhësore ose ndërkulturore, ku N mund të gjejnë edhe libra në gjuhën e tyre. Edhe aty ku kjo nuk është e mundur, megjithatë, nuk duhet të hiqet dorë nga vizita e bibliotekës. Pikërisht për N me familjet më pak të arsimuara mund të hapet një botë krejt e re, e pasur. Përveç kësaj, në këto biblioteka mund të gjenden edhe libra reference etj, të cilët janë të vlefshëm për MGJP.
- Është e rëndësishme që, para se të vizitohet biblioteka, të pyeten M e klasëve të rregullta se sa thellë janë futur tashmë në përdorimin e bibliotekës dhe çfarë mund të thellojnë më tej.
- Para vizitës, është e rëndësishme që të kontaktohet stafi i bibliotekës për t'i lajmëruar. Ndoshta është e mundshme që biblioteka të bëjë gati libra në gjuhën e prejardhjes së N ose t'i porosisë në mënyrë të veçantë. Lidhur me këtë, është e rëndësishme të sqarohet paraprakisht se si janë kushtet e huazimit. Në shumë komuna huazimi është falas për N.
- Do të duhej të jetë e mundur që të gjithë N të huazojnë nga një libër. Në orët vijuese ata duhet të kenë mundësinë për t'ua treguar shkurtimisht të tjerëve në klasë.

5

Libra-domino

Qëllimi

Domino mund të luhet edhe me libra. Përmes një mënyre të parëndomtë do t'i ofrohet N një koleksion librash ekzistues (p.sh. nga biblioteka) ose ata do të njohin libra të rinj (nga prona private).

kl. 1–9

20–30 min.



Materiali:

Mundësisht shumë libra të ndryshëm, libra të ilustruar, revista etj.

Rrjedha:

- Një sasi librash do të shpërndahen në klasë, në mënyrë që secila nxënëse/secili nxënës (ose grupet nga 2–3 N) t'i ketë para vetes 3–4 libra. Sigurisht, që do të merret parasysh mosha e N gjatë shpërndarjes, për këtë arsye duhet që fillestaret/ët natyrisht të mbështeten. Të gjithë kanë nga pesë minuta për t'u njohur nga afër me librat. Ata i shikojnë ballinat me përpikëri, e lexojnë tekstin në faqen e brendshme të ballinës dhe shfletojnë librin. Ndoshta librat kanë ilustrime, një tabelë të përmbajtjes, janë të ndarë në kapituj ose ka një portret të shkurtër për autorin etj. Qëllimi është që N në këtë fazë të përpunojnë karakteristikat rreth librave, të cilët ata mund t'i përdorin më vonë në lojë.
- Kështu M e vendos të parin një libër dhe e karakterizon në bazë të veçorive të identifikuara. Ai mund për shembull të thotë: «Është një libër me fotografi, është me ngjyra, tema është natyra në vendin tonë të prejardhjes.» Pastaj, si në lojën tradicionale të dominos, do t'i shtohet një «gur» i përshtatshëm, d.m.th. një libër i dytë me një ose më shumë karakteristika të përshtatshme (shih më poshtë). Kush do që të shtojë një libër, shpjegon se pse ai e ka vendin atje. Zgjedhja duhet të përligjet me



Hija
në kullën
e vjetër



Fantazma
e vogël



Përrallat e
1001 netëve



Përrallat
e vëllezërve
Grim



Mbreti
bretkocë



Mbreti i
luanëve

një karakteristikë të njëjtë; grupi vlerëson nëse kriteri i përshtatet. Janë të lejueshme karakteristika të thjeshta (p.sh., kapakët janë gjithashtu blu, ajo është shkruar gjithashtu nga një grua, edhe titulli fillon gjithashtu me «të ...»), deri te arsyetimet më komplekse, ndoshta të lidhura me përmbytjen (të tilla si: libri është edhe një triller, personazhet kryesore janë gjithashtu vëllezër e motra, ngjarja zhvillohet gjithashtu në Shqipëri).

- Loja vazhdon aq gjatë derisa të gjithë librat të jenë përfshirë në domino, ose ndërpritet pas 10–15 minutash. Në vazhdim mund të zhvillohet një bisedë e shkurtë në pyetjen: «Cilin nga librat që janë vendosur poshtë, ti do të doje ta lexoje veçanërisht me kënaqësi?»

6

Fjalitë e para

Qëllimi

Me këtë ide N i njohin librat dhe tekstet e ndryshme (artikujt etj.), ata ngrenë hipoteza dhe kështu trimërohen për të lexuar tekstin e tërë. Ndoshta shkruajnë edhe ndonjë tregim individual për një fjalë të parë, e cila u ka pëlqyer veçanërisht shumë.

kl. 2–9

60 min.



Materiali:
Një përzgjedhje e librave të ndryshëm dhe e revistave (bëhen gati nga M), letër-A3.

Rrjedha:

- Për shumë autorë, fjalja e parë e një libri ose teksti është vendimtare. Për lexueset dhe lexuesit gjithashtu shpesh!
- N kërkojnë në libra dhe revista fjalitë e para, të cilat u pëlqejnë veçanërisht shumë. N më të rinj i ndihmon M ose ndonjë fëmijë më i rritur. Nxënësit i shkruajnë fjalitë e gjetura lexueshëm në një letër-A3. Mundësitë për punë të mëtejshme në grupe ose në seancë plenare:
 - a) N i lexojnë fjalitë dhe përpiqen të kuptojnë se nga cili libër apo nga cila revistë mund të jetë marrë fjalja e caktuar.
 - b) N ngrenë hipoteza, se çfarë tregimi mund të jetë ai që fillon me fjalinë përkatëse. Ata, gjithashtu, përpiqen të zbulojnë gjininë e tekstit (tregime kriminale, përralla, artikuj gazetash, histori realiste, libër faktik, udhëzues për përdorim etj).

Variantet:

- Secili N kërkon në mesin e fjalive fillestare të ngjitura një fjali, e cila i pëlqen më shumë dhe nëpërmjet saj madje sajton vetë një tregim. Pastaj tregimet e sajura vetë do të krahasohen me tekstet e vërteta.
- N kërkojnë nga librat dhe tekstet e ndryshme vetëm fjalitë e fundit dhe përpiqen, nga fundi i hipotezës, të zhvillojnë më tej përmbytjen e teksteve përkatëse ose origjinën e tyre (nga cili libër ...).
- Një nivel të mirë zgjerimi paraqet ushtrimi vijues nr. 7 (Të ngrihen hipotezat).

7

Të ngriten hipotezat

Qëllimi

Një faktor i rëndësishëm motivimi gjatë leximit të librave artistikë është që rrjedhën e veprimit mund të krahasojmë me pritjet individuale dhe hipotezat. Në varësi vërtetohen supozimet individuale ose dalin që të jenë të gabuara. Kjo është veçanërisht emocionuese gjatë të lexuarit të librave me aventura apo kriminalistikë. Ushtrimi e forcon ndërgjegjësimin e N për formimin e hipotezave dhe nxjerrjen e kuptimit.

kl. 2–9

25–45 min.



Materiali:
Libra të ndryshëm
(të përgatitur nga M).

Rrjedha:

- N lexojnë në ekipe dyshe (p.sh. kapitullin e parë apo faqen e parë) të një tregimi. Lexuesve më të rinj apo më të dobët kjo edhe mund t'u lexohet plotësisht ose pjesërisht ose t'u ritregohet (për këtë mund të formohen ekipe nga N të rinj dhe të vjetër). Në varësi të përbërjes së klasës, do të vihen në dispozicion libra të ndryshëm për këtë ide (mosha, gjinia, interesa të veçantë). E rëndësishme: Duhet të merren vetëm tekstet që cilat i ka lexuar të paktën një fëmijë tjerër i klasës dhe i njeh.
- Pastaj ekipet dyshe i diskutojnë dhe i regjistrojnë hipotezat e tyre për ndodhinë e mëtejshme (si do të mund të vazhdojë tregimi më tutje, çfarë do të ishte emocionuese, e frikshme, gazmore etj?).
- Nëse tashmë askush nga klasa nuk e ka lexuar tekstin ose librin, atëherë N i kontrollojnë hipotezat e tyre vetë. Ata e lexojnë librin dhe i krahasojnë hamendësimet e tyre për rrjedhën me origjinalin.

Vërejtje:

Një ushtrim paraprak të mirë dhe të thjeshtë paraqet ushtrimi nr. 6 (Fjalitë e para).

Variantet:

- Nëse të gjithë ose shumica e grupeve e kanë lexuar kapitullin e parë atëherë e zhvillojnë një diskutim: Cila hipotezë është më e mundshme, pse?
- Ushtrimi është gjithashtu i përshtatshëm si hyrje në një lexim të përbashkët të klasës. Fillimi i këtij libri do të lexohet para të tjerëve; të gjithë N shkruajnë hipotezat e tyre për tekstin. Këto pastaj do të ruhen në një «arkë thesari». Pas përfundimit të leximit të përbashkët do të shikohet, nëse njëra prej hipotezave ishte e saktë.

8

Libra në qese të mrekullueshme

Qëllimi

Para se gjithash fëmijët e vegjël i duan befasitë. Me këtë ide ata do të bëhen veçanërisht kureshtarë mbi përmbajtjen e një libri. Kjo mund të jetë përkrahëse për motivimin e tyre në të lexuar.

kl. 1-9


30 min.



Materiali:
Libra të ndryshëm,
letër dhuratash.

Rrjedha:

- M paketon për çdo nxënës/çdo nxënëse një libër në një qese nga letra ambalazhi me ngjyrë (tek përsëritjet e mëvonshme këtë mund ta bëjnë edhe N më të vjetër). Të gjitha këto qese janë të vendosura në një shportë dhe paraqiten para klasës. Ka kuptim që për grupmoshat e ndryshme të zgjidhen edhe ngjyra të ndryshme (qese të kuqe = për më të vegjlit: e kaltër: klasa e 4-6, e gjelbër: për klasën 7-9).
- Çdo fëmijë mund të marrë një «qese të mrekullueshme» dhe ta nxjerrë prej saj librin e fshehur. Pastaj duhet t'u jepen të paktën 10 minuta për një lexim të parë, shfletim e lexim me ëndje. Nëse një fëmijë tashmë e njih librin e tij ose kur nuk mund të fillojë absolutisht me të, atëherë mund ta ndërrojë tek M.
- Në fund të sekuencës N marrin librin e tyre në shtëpi për ta lexuar atje ose caktojnë dikë që t'ua lexojë atyre. Pas një apo dy javësh, librat do të kthehen në shkollë. N i tregojnë njëri-tjetrit se çfarë kanë lexuar, i krahasojnë me të tjerët dhe i japin njëri-tjetrit këshilla për lexim.



Variantet:

Në qeset e mrekullueshme, gjegjësisht paketat gjenden libra të cilët N tashmë i njohin (p.sh. të tilla të cilat M gjatë vitit shkollor ua ka lexuar ose që janë paraqitur nga N e tjerë). N informohen edhe një herë saktësisht për përmbajtjen e librit të tyre (pa ua treguar këtë të tjerëve) dhe shënojnë pyetje enigmatike: «Babai i personazhit kryesor në librin tim është një mbret.» «Ngjarja e librit tim zhvillohet në vendin tonë të prejardhjes, para rreth 1000 vjetësh.» «Personazhi kryesor i librit tim ka dy gërsheta të kuqe.» Të dhënat e para do të duhej të jenë shumë të përgjithshme; nëse askush nuk e zbulon librin, atëherë do të jepen të dhëna gjithnjë e më të veçanta.

9

Sekuenca të lira leximi
(lexim individual)

Qëllimi

Përveç punës së përbashkët me tekst në klasë, N kanë nevojë për periudha gjatë të cilave ata mund të lexojnë sipas ritmit të tyre, në bazë të interesave të tyre personale dhe në pajtim me mundësitë e tyre. Kjo mund të rrisë motivimin dhe kompetencën e tyre në të lexuar në mënyrë të konsiderueshme.

kl. 1–9

20–30 min.



Materiali:

Libra, revista, tekste të përdorura dhe të përditshme, eventualisht faqe të zgjedhura në internet.

Rrjedha:

Sekuenca e lirë në të lexuar zgjat 20–30 minuta; ajo mund të përmblihet nëpërmjet një bisede në klasë, në të cilën të gjithë N ose secili veç e veç flasin për librin e tyre, shtrojnë pyetje ose japin rekomandime.

Udhëzimi:

- Sekuencat e lira në të lexuar duhet të praktikohen rregullisht. Rrethana të mira ofrojnë në MGJP ato sekuenca gjatë të cilave M punon me grupet e moshave të tjera.
- Në sekuenca të lira në të lexuar N mund të përcaktojnë vetë, se çfarë duan të lexojnë. Ata mund të tërhiqen në një pjesë të klasës dhe duhet të mos bëjnë asgjë tjetër pos të lexojnë.
- Në mënyrë që koha për lexim të lirë të shfrytëzohet me frytshmëri, N duhet të mësohen se si të bëjnë një plan leximi dhe pastaj si të udhëheqin një protokoll leximi, i cili mund të shërbejë eventualisht edhe në rast të një bisede që ndodh për leximin e tyre individual. Për të dy pikat gjenden shembuj konkretë tek propozimi mësimor nr. 11.
- Tek fëmijët dhe të rinjtë, të cilët nuk janë mësuar që për 20 minuta të bëjnë një punë të qetë për vete dhe që ende nuk e kanë gjetur rrugën për t'u thelluar qetësisht në libra, është mirë që edhe këto sekuenca të lira të të lexuarit të strukturohen qartë për ta. Së paku në fillim janë të rëndësishme porosi dhe udhëzime të qarta. Këtu parashihet që gjatë këtyre sekuencave të mos ketë zhurma dhe shpërqëndrim, që N kohën e tyre për lexim ta planifikojnë paraprakisht dhe, pas sekuencës së lirë të leximit, të japin llogari se çfarë dhe sa kanë lexuar gjatë kësaj kohe.
- Një plotësim dhe shumëllojshmëri për sekuenca të lira në të lexuar është të lexuarit në grupe ose në bashkësinë e klasës, shiko më poshtë nr. 11.



10

Leximi para të tjerëve dhe incizimi i zërit për të tjerët

Qëllimi

Ideja ndjek dy qëllime:

1. Nga njëra anë, N mësojnë për të lexuar para të tjerëve një tekst rrjedhshëm e në mënyrë shprehëse (në formë artistike) dhe për ta incizuar në një magnetofon.
2. Në anën tjetër, duhet që tek N e rinj të përkrahët interesimi për tekstet, nëpërmjet asaj që N të mund të përdorin incizimet e bëra dhe ato të mund t'i dëgjojnë në formë të audiolibrave, në shtëpi ose në shkollë.

kl. 2-9

30-45 min.



Materiali:


Tekste të ndryshme (tregime të shkurtra, poezi, artikuj interesant, gjëgjëza, humor, episode, libra etj.), mjet për incizim të zërit.

Rrjedha:

- Së pari, duhet që M me N të jenë të ndërgjegjshëm se çfarë e bën «të bukur» dhe shprehës të lexuarit para të tjerëve. Kjo mund, për shembull, të bëhet nga M, i cili e lexon së pari një tekst të shkurtër keq (mërzitshëm, me zë të ulët, monoton dhe jo qartë) dhe pastaj e lexon mirë: Cilat ishin dallimet, nga vjen kjo? Kriteret do të shënohen në dërrasën e zezë.
- Pastaj N marrin tekste vetëm, në çifte ose në treshe, po edhe mund ta zgjedhin vetë tekstin. Ata ushtrojnë që ta lexojnë para të tjerëve në mënyrë shprehëse (në formë artistike). Në varësi të tekstit ata mund të lexojnë sipas roleve ose të ndërrohen pas një pjese leximi.
- Nëse të lexuarit para të tjerëve në një farë mase shkon mirë, do të krijohet një dokument i incizuar. Regjistrimi mund të bëhet nëpërmjet telefonit, kompjuterit, regjistruerit të zërit apo magnetofonit. E rëndësishme: M duhet patjetër të ketë kujdes që të arrihet një cilësi e mirë regjistrimi (të bëhen më parë regjistrime provuese!).
- Dokumentet e përfunduara të regjistrimit mund t'i paraqiten klasës. Këto regjistrime mund dhe duhet gjithashtu të merren si huazim për në shtëpi ose për sekuenca të lira leximi. Skedarë elektronikë (MP3) ose CD mund tu vihen sigurisht në shfrytëzim personave ose klasave të tjera.

Vërejtje:

- E rëndësishme: Nuk do të duhej të lexohet para të tjerëve, pa e ushtruar të lexuarit më parë. Të ushtruarit mund të jetë i mirë edhe si detyrë shtëpie nëse N e dinë paraprakisht se çfarë duhet të kenë parasysh tek të lexuarit e bukur para të tjerëve.
- Veçanërisht të përshtatshme janë njësi më të vogla të tekstit (tregime të shkurtra, gazmore, episode, poezi, dialogje). Është gjithashtu e mundshme që të incizohet një libër i tërë (të jetë mjaft i shkurtër), krahaso këtu propozimin mësimor 1.
- Regjistrimet mund të bëhen sigurisht edhe të shoqëruara me tinguj, muzikë etj.; e deri te krijimi i lojërave të vogla dëgjimore. Kjo sigurisht edhe mund ta tejkalojë buxhetin e MGJP, prandaj duhet që ndoshta, të paktën një pjesë e kësaj pune, të bëhet si detyrë shtëpie.
- Që në fillim N duhet ta dinë se po krijohet një produkt i përshtatshëm (CD, koleksion i audiofile etj.). Dizajni i produktit (mbështjellësi i CD) dhe prezantimi i tij në internet apo në ndonjë mbledhje me prindërit, mund të jenë elemente të tjera të këtij projekti.
- Projekti është i përshtatshëm për të punuar me mësuesit e klasës së rregullt. Për shembull, mund të krijohen regjistrimet audio dygjuhëshe ose shumëgjuhësore.
- Natyrisht, mund të lexohet drejtpërdrejt para të tjerëve ndonjë tekst i klasës.



11

Leximi në grup ose me tërë klasën

Qëllimi

Është stimuluese dhe udhëzuese për t'i ndarë përvojat e leximit në të gjitha nivelet e shkollave. Mund të mendohet për një tekst të lexuar së bashku dhe pastaj të shkëmbehen mendimet. Kështu hapen perspektiva të reja dhe përjetohen mënyra të tjera të të menduarit. Të lexuarit e përbashkët ofron mënyra optimale dhe të llojllojshme për komunikim të mëtejshëm (shih më poshtë).

kl. 1–9

30–90 min.



Materiali:
Disa libra ose tekste identike.

Variante:
tekste të ndryshme
për temën e njëjtë.

Rrjedha:

1. Faza e leximit 1 (mbi veprimet metodike, shih më poshtë)

Opcioni 1: Të gjithë N lexojnë të njëjtin libër ose të njëjtin tekst. Ky variant është tërheqës në aspektin e përvojës së përbashkët të leximit. Por për MGJP ky është ndoshta i vlefshëm vetëm në qoftë se teksti është i përshtatshëm për të gjitha nivelet ose nëse klasa nuk përfshin shumë nivele të moshave.

Opcioni 2: N lexojnë tekste të ndryshme për të njëjtën temë. Në kuptim të përvojës së përbashkët të leximit zgjidhet një temë gjithëpërfshirëse, për shembull, «Nga historia e vendit tonë të prejardhjes», «Poezi», «Tekste faktike për vendin tonë», «Tekste të ndryshme të poetit tonë XY». Por tekstet mbi këtë temë, duhet të ndahen sipas moshës apo nivelit të kërkesave (p.sh., tri tekste faktike me kërkesa të ndryshme nga gjeografia; tri tekste me gjatësi dhe kërkesa të ndryshme etj). Leximi atëherë nuk bëhet me tërë klasën, por në tri nivele, sipas grupmoshës, shkallës ose të nivelit të grupeve.

2. Komunikimi vijues, diskutimi, përpunimi

Kjo zhvillohet në varësi të variantit të përzgjedhur më sipër ose me tërë klasën (tek versioni 1) apo së pari në grup (tek versioni 2). Gjithashtu për versionin 2, përvojat në të lexuar duhet të shkëmbehen me tërë klasën. Tek klasat MGJP fort të përziera në moshë mund të përfitojnë para se gjithash N e rinj nga ata më të vjetrit përmes asaj që ata shohin se si ata merren me tekstet dhe si flasin për tekstet e lexuara.

Variantet dhe mundësitë e komunikimit vijues: biseda, diskutime për dhe kundër, luajtja e roleve / zbatimi në skenë, përpunimi me shkrim etj.

Procedura metodike (si do të lexohet?)

Duhet shmangur leximin tradicional e të tejkualuar me rend, gjatë të cilit çdo fëmijë lexon një pjesë e më pas vazhdon tjetri. Kjo procedurë nuk e rrit kompetencën në të lexuar dhe as nuk e ngren motivimin për të lexuar. Janë tepër të ndryshme tempoja e leximit, mënyrat e leximit dhe kompetencat në të lexuar.

Këshillohet varianti vijues: Për të lexuar, N do të ndahen në ekipe dyshe ose treshe. Gjatë formimit të ekipeve duhet të merret parasysh që të mos jenë në një grup N me aftësi shumë të ndryshme në të lexuar.

Secili ekip, para leximit, krijon një plan leximi. Pas leximit ekipet mbajnë një protokoll të leximit, ku shënojnë se si kanë vepruar gjatë leximit dhe çfarë ishte më e rëndësishmja në përmbajtje. Shembuj të planit për lexim dhe protokollat e leximit mund të gjenden më poshtë.

Menjëherë ato ekipe që kanë mbaruar leximin, do të marrin detyra shtesë në formën e mëposhtme:

- Ushtroni për të lexuar para të tjerëve një kapitull aq gjatë derisa ju ta bëni atë pa gabime. Pastaj bëni një incizim, të cilin ju mund ta vini në shfrytëzim edhe për shokët/shoqet e klasës suaj.
- Përmbliidhni kapituj veç e veç dhe paraqitni ata më pas. Këtë mund ta bëni, për shembull, në formën e një teksti, të luajtjes së një roli, një vizatimi ose grafike.
- Zgjeroni njohuritë tuaja mbi këtë temë; bëni hulumtime shtesë për temën ose autorin.

Vërejtje:

- Motivimi në të lexuar rritet kur N në përzgjedhjen e leximit mund të bashkëvendosin. Në këtë kuptim, do të duhej që të vendosen përpara tekste të ndryshme apo libra për përzgjedhje (2–4 për grupmoshën apo nivelin), në mënyrë që të ketë përzgjedhje të vërteta.
- Leximi në grup ose në bashkësinë e klasës do të duhej sigurisht të përsëritet vazhdimisht. Ai përfaqëson një plotësim të mirë dhe larmi në raport me leximin e lirë (shih për këtë propozimin mësimor 9).

Shembuj për planin e leximit, protokollin e leximit:

Shembujt janë menduar si sugjerime dhe natyrisht mund të modifikohen. Në veçanti, plani i leximit mund të formulohet në formën -ti (në vend të formës së -ju); një formulim i tillë pastaj mund të përdoret shumë mirë për leximin individual.

Plani i leximit i ekipit: _____

Para se të filloni me leximin, është e vlefshme që të planifikoni sasinë e leximit dhe kohën e leximit.

Shënoni në tabelë: Cilin kapitull po e lexoni? Deri kur do ta keni lexuar këtë kapitull?

Kapitulli	Deri kur?
_____	_____
_____	_____
_____	_____

Data: _____

Nënshkrimi i mësimitdhënësit: _____

Nënshkrimet e ekipit: _____

Protokoll i leximit i ekipit: _____

Pas leximit do të duhej vazhdimisht të mendoheni se si ka rrjedhur të lexuarit dhe a ka funksionuar planifikimi (plani i leximit). Plotësojeni për këtë pjesën vijuese!

Si kemi lexuar ne

- Ne lexuam të gjithë në qetësi.
- _____ lexoi para të tjerëve.
- Ne kemi shkuar aq larg, sa kemi planifikuar.
- Ne kemi ardhur deri te faqja _____.
- Ne kemi shkuar më tutje në mënyrë të ndryshme. Por të gjithë e dinë rrëfimin deri te faqja _____.

Çfarë kemi lexuar ne: _____

Ky person, veprim ose situatë na ka impresionuar veçanërisht:

Shënoni me 2–3 fjali, përse ky person, veprim apo akt ju ka impresionuar!

Këto janë për ne fjalitë më të rëndësishme nga ajo që kemi lexuar:

**Shembull
Protokoll leximi
(Klasa e 1 dhe e 2)**





Titulli i librit: _____

Autori/Autorja: _____

Ilustrimi:

Fjalët: _____

Unë mendoj se libri isht

shumë i mirë 	i mirë 	mesatar 	jo i mirë 
---	---	--	--

12

Kush e zbulon librin tim?

Qëllimi

Me këtë ide mësimore N njoftohen me libra të rinj dhe tekste dhe motivohen për të lexuar. Nëse ata e kërkojnë vetë një faqe dhe e lexojnë para të tjerëve, ata duhet të merren intensivisht me librin «e tyre» ose me tekstin; në të njëjtën kohë ata praktikohen për të lexuar para të tjerëve dhe për të dëgjuar me vëmendje.

kl. 1–9

60 min.



Materiali:

Një përzgjedhje e librave dhe teksteve të tjera (libra me fotografi, enciklopedi, revista etj).

Tekstet mund të sillen nga M dhe/ose nga N.

Rrjedha:

- Secila nxënëse, secili nxënës kërkon një libër ose një tekst tjetër. N e tjerë nuk duhet të shohin se për cilin libër po bëhet fjalë. Fillestarët/et gjithashtu mund të zgjedhin një libër me figura.
- M bën një listë, në të cilën N e shënojnë «fshehurazi» titullin e librit të tyre.
- N e mbështjellin librin e tyre, ashtu që faqja e parë nuk është më e dukshme.
- N kërkojnë në librin e tyre një fragment, i cili të jetë i përshtatshëm për lexim para të tjerëve (fragmenti duhet të jetë emocionues apo interesant, por nuk duhet të zbulojë menjëherë gjithçka). Zgjedhja e një pjese të përshtatshme (rreth 1/3–1 faqe) kërkon shqyrtim të thelluar të tekstit.
- Leximi duhet të ushtrohet! N u jepet kohë e mjaftueshme për ta ushtruar të lexuarit para të tjerëve (mundësisht jashtë klasës). Kjo gjithashtu mund të jepet edhe si detyrë shtëpie. Fillestarët/et, të cilët kanë zgjedhur një libër me figura, kanë për detyrë të përshkruajnë figurën e tyre të zgjedhur sa më qartë që të jetë e mundur.
- Tani N ia lexojnë klasës tekstin e tyre (ose e përshkruajnë figurën e tyre të zgjedhur). Dëgjuesit përpiqen të zbulojnë se nga cili libër vjen pjesa e tekstit apo çfarë gjinie të tekstit i përshtatet (kriminalistik, libër faktik, përrallë etj). Sekuencat e të lexuarit para të tjerëve dhe sasia e të lexuarit mund të shpërndahen gjithashtu përgjatë 2–3 orëve mësimore.

Vërjetje:

Ushtrimi mund të organizohet edhe si një konkurs i vogël. Kush e zbulon i pari titullin, shpallet fitues.

Variantet:

Projekti mund të ndryshohet në shumë mënyra. Shembuj:

- Mund të përzgjidhen gjithashtu libra edhe në gjuhën e shkollës; Prezantimi do të mbahet natyrisht në gjuhën e parë.
- M lexon para N në fund të vitit shkollor pjesë nga tekstet, që janë trajtuar gjatë vitit shkollor. Për cilin tekst po bëhet fjalë?
- Të gjithë titujt do të kopjohen në një fletë letre dhe numërohen. N duhet që pjesët e lexuara t'i përcaktojnë se cilit titull i përkasin.
- Të gjithë titujt e librave do të shfletohen dhe do t'u jepen dëgjuesve. Tani ata duhet që pjesëve të lexuara t'ua përcaktojnë titujt.
- Zgjedhja do të kufizohet në një gjini të caktuar (titull nga letërsia artistike, tekst faktik, poezi, përrallë ...).

- N në një takim me prindër u lexojnë atyre pjesë të tekstit, prindërit marrin një listë të librave dhe duhet të zbulojnë se për cilin libër bëhet fjalë.
- N sjellin librat e tyre të preferuar dhe i lexojnë ata para të tjerëve.
- Prindërit, miqtë, mësuesit e tjerë janë të ftuar për të lexuar një faqe nga librat e tyre më të dashur.

13 Peri i gjëegjzës

Qëllimi

Për t'i përpiluar pyetjet e gjëegjzave për një libër ose tekst, N duhet të lexojnë me shumë kujdes, t'u kushtojnë vëmendje detajeve dhe të përqëndrojnë vëmendjen e tyre në pikat kryesore të tekstit. Zgjidhja e pyetjeve, sipas përvojës së bërë, i motivon fort veçanërisht fëmijët e rinj për të lexuar.

kl. 2-9

60 min.



Materiali:

Tekste (tregime jo shumë të gjata, artikuj të përzgjedhur nga revista apo nga interneti, libra, libra me figura për fëmijë); Shirit letre, gërshtë dhe penj.

Rrjedha:

- Punë individuale: N mund të kërkojnë një tekst, nga një përzgjedhje e bërë gati, që u intereson. Ata e lexojnë atë dhe, gjatë leximit, shënojnë edhe pyetjet, në të cilat mund të përgjigjen vetëm nëse vërtet e kanë lexuar me vëmendje përmbajtjen. Shembuj: Çfarë ka të veshur personazhi kryesor në ditën e parë të shkollës pas festave? Cili është emri i babait të personazhit kryesor? Në çfarë drejtimi rrjedh lumi XY?
- Pyetjet do të shkruhen në shirita letre dhe sipas radhës në të cilën ato do të përgjigjen në tekst. Pas çdo pyetjeje lihet hapësirë e mjaftueshme për përgjigje (ose të lihet hapësirë boshe në shirit ose të futen shirita të zbrazët me ngjyrë).
- Tani shiritat e letres do të lidhen me një pe. Pastaj dy N i shkëmbejnë mes tyre tekstet me pe.



- N e lexojnë librin ose tekstin e njëri-tjetrit/njëra-tjetrës (ndoshta si detyrë shtëpie) dhe përpiqen për të zgjidhur pyetjet me pe. Pas leximit do të krahasohen përgjigjet.
- Kush do të zgjidhë gjëegjza të tjera me penj, i merr nga N e tjerë tekstet me pyetjet përkatëse të gjëegjzës.

Vërejtje:

- Projekti «Peri i gjëegjzës» mund të zhvillohet gjatë disa javëve.
- Tek N e vegjël, të cilët ende nuk mund të lexojnë e të shkruajnë mirë, projekti mund të zhvillohet me anën e librave të ilustruar dhe me ndihmën e një fëmije më të moshuar, i cili e përgatit perin e leximit.
- Litarët e gjëegjzave, gjithashtu, mund të përgatiten në grupe në mënyrë që secili N duhet të lexojë vetëm një pjesë të një libri të tërë.
- Përvoja në biblioteka ka treguar që librat me litar gjëegjzash huazohen shumë më shpesh nga fëmijët më të vegjël.

Variantet:

N e përgatitin për secilin libër, i cili është në bibliotekën e klasës, një pe gjëegjzë, në mënyrë që, në fund të vitit shkollor, të gjithë librat të jenë të pajisur me një pe të tillë.

14 Pyetjet për librat të përpunohen

Qëllimi

Për të përpiluar pyetjet, në lidhje me një libër ose tekst, dhe për t'i zgjidhur ato, duhet që teksti të jetë lexuar dhe kuptuar mirë. Në veçanti, përpunimi i «pyetjeve për të kuptuar» dhe «pyetjeve për reflektim» (shih më poshtë) kërkon njohje më të thellë të përmbajtjes, ngase përgjigjet për këto pyetje nuk paraqiten shprehimisht në tekst.

kl. 4–9

45–90 min.



Materiali:

Libra, revista, event. tekste nga interneti; letër shkrimi.

Rrjedha:

- Pas leximit të një rrëfimi, një artikulli apo një libri të tërë, klasa ndahet në grupe dyshe. Grupet marrin për detyrë të përpunojnë pyetje për N tjerë në lidhje me përmbajtjen dhe kuptimin e mesazheve kryesore të tekstit. Pyetjet e tyre do të duhej të ndahen në tri kategoritë e mëposhtme:
 - **Pyetjet për rishikim.** Përgjigjet në këto pyetje mund të gjenden në tekst. Zakonisht ato janë unike (p.sh. me «e drejtë» ose «e gabuar» apo me një të dhënë të saktë) për t'u përgjigjur.
 - **Pyetjet për kuptimin.** Këtyre pyetjeve mund t'u përgjigjesh vetëm nëse mendohesh më saktësisht në lidhje me përmbajtjen. Këtu duhet të jesh në gjendje për të lexuar pak «midis rreshtave». Shpesh nuk ka përgjigje shumë të qarta për këto pyetje. (P.sh. Si ndjehet dikush? Pse veproji personazhi kështu?)
 - **Pyetje për reflektim.** Kjo kategori përfshin pyetjet që shkojnë përtej përmbajtjes. Nuk ka zgjidhje «të drejtë», këtu duhet të diskutohen përgjigjet së bashku. (p.sh. Çfarë pasojash sjell fundi i tregimit? Si do të kishte qenë e mundur që ky konflikt të zgjidhej ndryshe?)
- Pas përpunimit të pyetjeve N ia japin ato në një fletë M. Kështu M mund t'ua japë pyetjet ekipeve të tjera për të dhënë përgjigjet ose ato do të zgjidhen bashkërisht me tërë klasën.
- Dallimet mes llojeve të ndryshme të pyetjeve paraprakisht duhet të diskutohen saktësisht dhe përmes shembujve ato të bëhen të kuptueshme. Pyetjet për reflektim dhe kuptim duhet të diskutohen gjithsesi në plenum, ngase këtu nuk ka shpesh përgjigje të qarta.

Vërjetje:

- Në MGJP me grupet kryesisht shumë heterogjene të moshës, ushtrimet zhvillohen me përparësi në bazë të tri teksteve me kërkesa të ndryshme. Do të ishte bukur (por jo e detyrueshme) nëse këtu do të bëhej fjalë për një temë të njëjtë ose të ngjashme (p.sh. përralla nga vendi ynë i preardhjes; jeta në mërgim; racizmi; gjeografia).
- Në punën me N, të cilët kanë aftësi të pakta të leximit, pyetjet mund gjithashtu të kufizohen në dy lloje (pyetjet për të rishikuar dhe pyetjet për të kuptuar).

15

Të modelohet pllakat-reklamë për një libër

Qëllimi

N përgatitin një pllakat për një libër që e kanë lexuar. Për këtë ata nuk duhet vetëm të reflektojnë dhe të përmbledhin përmbajtjen e saj, por ata duhet gjithashtu të bëjnë më shumë hulumtime mbi autorin, temën etj. Një tjetër qëllim është që librin ta paraqesin në atë mënyrë që të tjerët të jenë gjithashtu të interesuar për përmbajtjen e tij dhe të motivohen për ta lexuar atë.

kl. 2–9

60–90 min.



Materiali:

Fletë letre të mëdha (A3 ose A2),
lapsa me ngjyra, ngjitës.

Rrjedha:

- Për projektin bëhet njoftimi dy deri tri javë më parë. N marrin për detyrë të zgjedhin një libër për të cilën ata duan të modelojnë një pllakat reklamues dhe ta sjellin. Të paktën më të rriturit duhet të marrin një detyrë plotësuese që të informohen në një bibliotekë ose në një librari, se si duken reklamat për librat (pllakate, artikuj në revista, recensione librash). Fillestarët/et mund të paraqesin librin e tyre më të dashur me figura ose me rrëfime, e në këtë punë mund të ndihmojë M ose një fëmijë më i rritur.
- Një javë para se të fillojë puna e vërtetë me pllakatet do të ketë një diskutim mbi çështjen se si mund të bëhet reklamë tërheqëse për një libër. Me siguri që pjesë përbërëse e kësaj pune është që N të përmbledhin përmbajtjen e librit në mënyrë sa më shumë emocionuese dhe interesante të jetë e mundur dhe të përdorin mjete grafike për të ngjallur interesin e lexuesit/es. Detyra: Eventualisht të kërkohen dhe të sillen informacione plotësuese për autorin, për vendin e ngjarjes, për kohën e veprimit si dhe materiale ilustruese.
- Tani vijon sekuenca (një orë ose dy orë), gjatë së cilës N do të bëjnë një pllakat mundësisht të bukur promovues të librit të tyre. Ndoshta ata mund edhe të sajojnë një slogan promovues për librin e tyre.
- Me të gjitha pllakatet së bashku do të bëhet një ekspozitë e vogël. Ndoshta edhe mund të zgjidhet pllakati më i mirë me anë të pikëve (çdo fëmijë mund t'i jepen tri pikë).

Vërejtje:

- Projekti është i përshtatshëm në mënyrë ideale për të bashkëpunuar me klasa të rregullta, qoftë në kontekstin e promovimit të leximit, qoftë si pjesë e një projekti javor për leximin. E vlen patjetër që, më parë, të kontaktohet mësuesi i klasës/mësuesja e klasës. Pllakatet, që lindin në kontekstin e bashkëpunimit të tillë, janë të dobishme ngase janë dygjuhëshe.

- Nëse një fëmijë nuk njeht asnjë libër në gjuhën e prejardhjes, por ka një libër të preferuar në gjuhën e vendit mikpritës, mund të diskutojë për këtë – por sigurisht në gjuhën e prejardhjes!
- Shumë biblioteka janë shumë të interesuara për postera apo tekste të nxënësve për librat. Sidomos është motivuese për klasën, nëse posterat e tyre do të varen në muret e bibliotekës.
- Me laptop ose celular nxënësit dhe nxënëset e vjetra mund të krijojnë një libër me ngjarjet kryesore. Një udhëzim i thjeshtë gjendet tek vjegja: <http://www.phlu.ch/dienstleistung/zentrum-medienbildung/medienbildung/buchtrailer>

16 «Book-Slam» (për kuptimin shiko te «Vërejtje»)

Qëllimi

Me këtë ide, të rinjtë duhet të motivohen, në njërën anë, për të lexuar. Në anën tjetër, ata mësojnë t'i përmbledhin përmbajtjet sa më saktësisht dhe t'i referojnë në një mënyrë tërheqëse dhe krijuese.

kl. 5–9

Ca. 90 min.



Materiali:

Libra të ndryshëm
(duke përfshirë libra faktikë,
vëllime me poezi, revista, etj),
bilbil, kronometër.

Rrjedha:

- Dy deri tri javë më parë M shpjegon termat «Slam» dhe «Book-Slam» (shih më poshtë). Ai/Ajo informon për projektin «Book-Slam» dhe përgatitjet e nevojshme: N duhet të vendosin në mënyrë individuale ose në grupe dyshe për një libër që ata duan ta paraqesin (si alternativë ata mund të zgjedhin edhe tekste të tjera si revista etj.). Të gjithë duhet të mendojnë për formën e tyre të prezantimit 3-minutësh. Kjo duhet të jetë mundësisht krijuese, tërheqëse, informative dhe me humor. (Për shembull: Rap, rrëfim i lirë, lexim para të tjerëve, komerciale etj). Shembuj të ndryshëm mund të gjenden në internet, duke kërkuar në Google fjalën «Book Slam».
- Përpunimi dhe ushtrimi i paraqitjes (një javë më parë, koha e nevojshme një orë mësimore).
Pasi N t'i kenë projektuar prezantimet e tyre, atëherë bëhen bashkë nga dy N ose nga dy ekupe dyshe. Ata i tregojnë njëri-tjetrit se çfarë kanë ndërmend të bëjnë dhe formulojnë shkurtore (feedback) dhe rekomandime për përmirësime. E rëndësishme: Të dhënat për përmbajtjen e librit duhet të jenë sa më të thukëta. Për detaje nuk ka kohë. N duhet të mendohen mirë se çfarë do t'u interesonte më së shumti dëgjuesve dhe me çfarë forme të prezantimit do të mund të tërhiqnin vëmendjen e tyre për librin dhe veten e tyre.
- Zbatimi (koha e nevojshme një orë mësimore):
Çdo nxënëse / nxënës, gjegjësisht secili ekip, ka më së shumti 3 min. kohë për prezantim. Dy N vrojtojnë me kronometër dhe bilbil respektimin e kohës.
Publiku i vlerëson librat e prezantuar apo tekstet, duke dhënë pikë për secilin libër ose tekst. Për këtë qëllim, N mbajnë kartat me numrat nga 1–9 lart; dikush numëron dhe i shënon të dhënat e rezultateve për çdo libër ose tekst në dërrasën e zezë. Fitues është libri ose teksti që do të ketë më shumë pikë. Të gjithë librat dhe tekstet do të ekspozohen dhe mund të huazohen nga N.

Vërejtje:

Për nocionin: Book-Slam është një variant i Poetry-Slam, d.m.th. një konkurs për paraqitje të referateve. Tek Book-Slam është fjala për të paraqitur një libër në mënyrë sa më krijuese të mundshme, për jo më shumë se tre minuta. Informacione të ndryshme dhe shembuj mund të gjenden duke kërkuar «Book-Slam» në internet; në mënyrë të veçantë për projektet shkollore merret vjegza www.bookslam.de.

Variantet:

Book-Slam janë shumë të përshtatshme për bashkëpunimin me klasat e rregullta. E vetëkuptueshme që në këtë rast do të prezantohen si projekte dy-ose shumëgjuhësore. Edhe mbrëmjet me prindër ose takimet me klasat partnere krijojnë kushte të mira për Book-Slam.

17 «Book-Dating» (për kuptimin shiko tek «Vërejtje»)

Qëllimi

N duhet të përmbledhin përmbajtjen e një libri ose teksti tjetër me pak fjalë dhe t'ia paraqesin partnerit përballë atë më të domosdoshmen në një grimëherë prej katër deri në pesë minutash. Në prezantime të shkurtra, N tjerë do t'iu tërheqet vëmendja për librat apo artikujt interesantë. Ata marrin rekomandime për lexim dhe përmes kësaj mund të nxiten për të lexuar libra ose tekste të caktuara.

kl. 4–9

60–90 min.



Materiali:
Libra të ndryshëm
(edhe libra tematikë,
vëllime poezish, revista etj.),
orë me kronometër.

Rrjedha:

- Përgatitja

Pasi që M e ka prezantuar nocionin dhe projektin, secili/secila N vendos për një libër ose një tekst. Pastaj përmbajtja do të përmbledhet shkurtimisht. Kjo mund të ndodhë me shkrim ose me disa fjalë çelës, të cilat ndihmojnë gjatë të treguarit. Do të hartohet një listë, duke shënuar kush dhe cilin libër ose cilin tekst do ta prezantojë. Përgatitja mund të plotësohet edhe për detyrë shtëpie.

- Zhvillimi

Klasa ndahet në dy grupe. Gjysma tregon, kurse gjysma tjetër dëgjon. Treguesi/ja shpërndahen brenda në klasë në tavolina të veçanta. Dëgjuesit mund të ulen për 5 minuta tek secili/secila tregimtar/e. Do të tregohet për përmbajtjen e librit dhe do t'iu përgjigjen pyetjeve eventuale. Pas 5 minutash, dëgjuesit do të kalojnë në një tjetër tryezë. Në raundin e dytë, rolet do të ndërrohen, në mënyrë që të gjithë N të mund të dëgjojnë njëherë dhe të tregojnë njëherë. Në një diskutim përfundimtar, përvojat do të pasqyrohen shkurtimisht dhe shembujt e rekomandimeve veçanërisht tërheqëse do të komentohen dhe do të arsyetohet cilësia e tyre.

Vërejtje:

Koncepti: «Book-Dating» është një variant i të ashtuquajturit «Speed-Datings». (takim në shpejtësi). Kjo është një metodë e organizuar për të kërkuar dhe ndërmjetësuar në gjetjen e një partneri/eje, në të cilin dy partnerë/e nga pesë minuta ulen përballë dhe flasin për veten e tyre. Në rast të një simpatie spontane ata takohen përsëri më vonë. Tek Book-Dating bëhet fjalë, që në një grimëherë prej jo më shumë se pesë minutash, flitet jo për të lëvdur veten, por për të lartësuar një libër dhe për ta bërë partnerin të interesohet për të.

18

Leximi para të tjerëve:
Të vlerësosh vetveten

Qëllimi

Shpesh N në MGJP i lexojnë para të tjerëve tekstet e tyre ose të huaja. Por leximi para të tjerëve duhet të mësohet dhe të praktikohet. Harku i vetë-vlerësimit mund të ndihmojë që N të jenë të vetëdijshëm për atë se çfarë ata tashmë mund të bëjnë mirë dhe në cilat fusha mund të përmirësohen.

kl. 2-9

20 min.



Materiali:

Kopjet e rrjetit për vetëvlerësim (shih poshtë).

Rrjedha:

Pasi një nxënës/e ka lexuar diçka para të tjerëve, ai/ajo plotëson fletën e vlerësimit për vetëveten. Ai/ajo pastaj e diskuton këtë vetëvlerësim me M. Pastaj diskutohen masat e duhura mbështetëse. Nëse një nxënës/e p.sh. lexon para të tjerëve me mëdyshje, atëherë ai ose ajo duhet të ndërmarrë ushtrime në fushën e leximit të rrjedhshëm (shih propozimin mësimor 22).

Leximi para të tjerëve:
Rrjeti për vetëvlerësim

Ngjyrosi me një ngjyrë të ndritshme ato fusha të cilat sipas teje janë të sakta!

Të lexuarit e saktë

Fjalët individuale dhe fjalitë e thjeshta i lexoj qartë dhe kuptueshëm.	Unë lexoj tekste të shkurta qartë dhe kuptueshëm. Unë bëj rrallë gabime në të lexuar.	Unë lexoj gjithashtu qartë dhe kuptueshëm edhe tekste të gjata dhe të vështira. Unë lexoj pa gabime.
---	---	--

Shpejtësia në të lexuar / Rrjedhshmëria në të lexuar

Pjesët e veçanta i lexoj rrjedhshëm, të tjerat ende me pengesa.	Unë lexoj të shumtën rrjedhshëm dhe me shpejtësi të qëndrueshme.	Unë lexoj rrjedhshëm, në përputhje me përmbajtjen, shpejt dhe ngadalë.
---	--	--

Udhëheqja e zërit / Shprehësia

Fjalët individuale i theksoj në përshtatshmëri me përmbajtjen.	Unë e ndryshoj zërin shpesh në përshtatshmëri me përmbajtjen.	Unë theksoj me plot shprehësi dhe e ndryshoj zërin tim. Unë i vë në përdorim me qëllim të caktuar pushimet.
--	---	---

19

Të rishihet të lexuarit personal

Qëllimi

N duhet të ballafaqohen me sjelljet e tyre në të lexuar, duke përdorur një pyetësor. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet plotësimit të pyetësorit M merr një pasqyrë mbi zakonet e leximit të N. Përmes kësaj ai/ajo mund të bisedojë me ta dhe preferencat e tyre në të lexuar t'i marrë më mirë parasysh.

kl. 2–9

20 min.



Materiali:
Kopjet e pyetësorit
(shih poshtë).

Rrjedha:

Secila nxënese, secili nxënës e plotëson pyetësorin e vet. M i grumbullon pyetësorët e plotësuar dhe jep vlerësime individuale. Këto diskutime nuk duhet të kryhen menjëherë, ato mund të zhvillohen gradualisht në orët e MGJP.

Vërejtje:

Është mirë që pyetësori të plotësohet përsëri pas 6 apo 12 muajsh për t'i krahasuar rezultatet. A ka ndryshuar shprehia e leximit tek N?

Variantet:

Pyetjet duhet të përshtaten me moshën e N. Për N më të rritur mund, për shembull, të futen pyetje shtesë për t'i lexuar në kompjuter.

Pyetësori për të lexuarit personal

Faqja 1 e pyetësorit:

1. Si lexoj unë

- Unë lexoj çdo ditë në shtëpi.
- Unë lexoj një deri dy herë gjatë javës në shtëpi.
- Unë nuk lexoj gati kurrë në shtëpi.
- Unë gjej gjithnjë diçka, të cilën do ta lexoja me dëshirë.
- Mua nuk më pëlqen kur dikush më lexon diçka.
- Unë lexoj me vetëdëshirë në shtëpi.
- Të shumtën e herës nuk i lexoj librat deri në fund.
- Unë lexoj të shumtën e herës në ekran.
- Unë gjithnjë gëzohem kur mund të lexoj diçka të re.

2. Çfarë lexoj unë

Unë lexoj tekste më shpesh në

- Gjuhën e parë Gjuhën e shkollës

Unë lexoj më me dëshirë

- Krimi
- Revista
- Artikuj në internet
- Libra nga të cilët mund të mësohet diçka (Libra faktikë)
- Libra ose tekste të tjera mbi vendin e prejardhjes
- Tregime me aventura
- Tregime dashurie
- Libra për shtrigat ose për magjitë
- Tregime të vërteta
- Futboll ose tregime të tjera sportive
- Wikinger Libra, të cilët rrefejnë për të kaluarën, p.sh. kalorësit, vikingët
- Komedi
- Tregime për kafshët
- diçka tjetër, domethënë: _____

Faqja 2 e pyetësorit:

Unë kam një libër të preferuar, një tregim të preferuar ose një faqe interneti, që unë mendoj se është veçanërisht interesante:
Titulli është si vijon: _____

Unë kam një personazh nga një libër ose nga një revistë.
Ai quhet: _____

3. Ku lexoj unë

Unë lexoj më me dëshirë ... (p.sh. në krevat, në mjedis të hapur, në shkollë etj.)

4. Për t'u menduar

- Unë flas me dëshirë me të tjerët për atë që kam lexuar.
- Unë jam i gëzuar nëse njerëzit e tjerë (p.sh. shoku/shoqja) më japin një këshillë për lexim.

Çfarë është veçanërisht me rëndësi gjatë të lexuarit tek unë?

Pjesa II: Ushtrimi në të lexuar



Ushtrimet dhe propozimet mësimore për ushtrimin në të lexuar ndahen në tri grupe:

Aftësitë në të lexuar

Propozimet mësimore 20–23:

Këtu paraqiten modele të mundshme për ushtrime, në të cilat mësimdhënësit mund t'u përshtaten rrethanave të veçanta të gjuhës së parë dhe nevojave të veçanta të klasës së tyre. Shkronjat, fjalët dhe fjalitë e shkurtra duhet të jenë kryesisht të automatizuara, në mënyrë që lexuesit të mund të përqendrohen në mesazhin e tekstit. Për nxënësit/et, që tashmë lexojnë rrjedhshëm dhe mirë, përpunimi i këtij lloji të detyrave nuk ka shumë kuptim. Ata, gjatë kësaj faze përkatëse të të ushtruarit, do të marrin për t'i lexuar tekste dhe libra sipas zgjedhjes së lirë. (shih më lart, nr. 9 «Sekuenat e lira të të lexuarit»).

Rrjedhshmëria në të lexuar (Fluency)

Propozimi mësimor 24:

Dikush mund ta kuptojë një tekst shumë më mirë, në qoftë se e lexon atë në një ritëm të caktuar. Përvoja ka treguar se te leximi i përsëritur, jo vetëm që lexonin më shpejt dhe rrjedhshëm, por edhe përmbajtjen e kuptonin më mirë. Edhe këtu vlen: sa më mirë të jetë automatizuar procesi i leximit, aq më tepër lexuesit mund të përqendrohen në përmbajtjen e një teksti dhe do ta kuptojnë më mirë atë.

Të lexuarit e rrjedhshëm duhet të ushtrohet në shumë sekuenca të shkurtra leximi, për shembull, rreth tri deri në katër javë, çdo ditë në fillim të mësimit, 10–15 minuta. Këto forma ushtrimi për lexim të rrjedhshëm mund të krahasohen me një trajnim fizik në sport ose me ushtrime të gishtërinjve në një instrument muzikor.

Strategjitë në të lexuar

Propozimet mësimore 25–27:

Në pjesën e tretë të ushtrimit do të tregohet se si nxënësit/et mund të mësojnë që, në mënyrë të vetëdijshme, të përgatiten për tekste të ndryshme dhe për lexim. Do të jepen shembuj për hartimin e tekstit dhe do të propozohen ushtrime se si të përmbledhen tekstet dhe të vlerësohen në mënyrë të pavarur.

Strategjitë në të lexuar duhet të jepen nga mësimdhënësi nëpërmjet diskutimeve mësimore në klasë. Pas përpunimit ato duhet të ushtrohen dhe përforcohen në mënyrë të përsëritur me tekste të ndryshme. Kjo realizohet më së miri kur merren ato tekste që janë aktuale në klasë.

Për fushën e strategjive të leximit jepen gjithashtu referime në librin «Dhënia e strategjive dhe teknikave mësimore në MGJP» (Fletorja 5 e serisë «Nxitje didaktike për MGJP») ku në pjesën II dhe III gjenden strategji të tjera të dobishme për fushën e leximit.

20

Unë i njoh menjëherë shkronjat

Qëllimi

N e ushtrojnë aftësinë e tyre, për t'i njohur shkronjat dhe rrokjet me shikim të parë. Kjo çon tek një shpejtësi më e mirë në të lexuar.

kl. 1–4

10–15 min.



Materiali:
Varësisht nga lloji i ushtrimit,
fletë të parapërgatitura,
shih më poshtë.

Rrjedha:

Qëllimi i identifikimit të automatizuar të shkronjës së mundshme në gjuhën e parë – sidomos për ata që nuk e njohin atë nga gjuha e shkollës – mund të kontrollohet me ushtrime të ndryshme. Shembuj:

- Të mblidhen shkronja (shih më poshtë ushtrimin a; detyrat mund të ndryshohen sipas dëshirës).
- Të bashkohen shkronjat. Për këtë qëllim janë të përshtatshëm dy ose tre shirita letre, në të cilët ABC-ja është shkruar lexueshëm. Këta shirita tani mund të vendosen pranë ose nën njëri-tjetrit dhe të zhvendosen pranë njëri-tjetrit, në mënyrë që gjithnjë të lindin kombinime të reja.
- Grupet e shkronjave të njihen shpejt (shih më poshtë ushtrimin b).
- Rrokjet të bashkohen (gjithashtu shkon mirë me shirita, siç përkruhet më sipër tek «Të bashkohen shkronjat»).
- Të lexohen shkrime të pazakonshme (këtë mund ta bëjnë M në kompjuter duke e kthyer një tekst në tipe të ndryshme shkrimi).

Vërejtje:

- Natyrisht një vlerë të rëndësishme në këto ushtrime marrin ato shenja të cilat N nuk i njohin nga gjuha e shkollës. Krahaso për këtë Kap. 1a në hyrje.
- Shumë ushtrime janë të përshtatshme për të punuar në punë me partner.
- Shumë prej këtij lloji të fletëve të ushtrimit mund t'i bëjnë N e vjetër për të rinjtë.
- Sigurisht, ushtrimet e këtij lloji, nëse është e nevojshme gjithashtu mund të kryhen me N e vjetër, në qoftë se ata ende kanë paqartësi në identifikimin e grafemës në gjuhën e parë.

Ushtrimi a)

Sa M i gjen ti?
Kërkoji të gjitha P!
A ka më pak apo më shumë Ë?

P T U F M Ë H J K F M L R Ë D M N P Q M Z G G O P
H Ë M N Ë S L R J L M Ë N D H B Ë B E Ë M Ë K R Th
Gj N O Y P B M Ë Z K P Ë N L R N P E R N L G P A M
E J L K A G T H I R Dh L B P M T A B P C N R M S L F
J P Q X Y G I D M T K T Nj Q Zh A Rr Q M O D G F H
K R O E N X M Xh N V C I K T L Th P N E M O U T F
H G Dh L B P M Zh A Rr Q J L M Ë N D P Q X Y G I D
B Ë B E Ë M Ë K R Th Gj N O Y P B M Ë Z K P Ë N L R
N P E R N L G P A Ë M N Ë S L R J L M Ë N D H B Ë

Ushtrimi b)

Kërko tek fjalët e mëposhtme sh, shp, dhe pr. Shkruaji se sa i ke gjetur.

sh ○ shp ○ pr ○

shkolla, pëshpërit, pres, shqip, Prishtina, shtëpia, shpejtësia, pranvera, ashpërsia, shqiponja, provoj, shpërqëndroj, shpirti, prapësoj, shteti, pranoj, shporta, pragu, Shqipëria, shpati, prek ...

21

Unë i lexoj fjalët gjithnjë e më shpejt

Qëllimi

Qëllimi është njohja e shpejtë e fjalës, si dhe ushtrimi dhe zhvillimi i ilustrimeve të fjalëve shumë të shpeshta, të cilat identifikohen menjëherë dhe nuk duhet të deshifrohen shkronjë për shkronjë (leksik pamor). Kjo çon në një shpejtësi më të mirë leximi.

kl. 1–4

10–15 min.



Materiali:
Varësisht nga ushtrimi,
fletë të parapërgatitura,
shih më poshtë.

Rrjedha:

Qëllimi i identifikimit të mundshëm të ilustrimeve të fjalëve veçanërisht të shpeshta në gjuhën e parë mund të drejtohet me ushtrime të ndryshme. Shembuj:

- Leximi i fjalëve me pengesa (shih më poshtë ushtrimin a).
- Njohja menjëherë e fjalëve të vogla (shih më poshtë ushtrimin b).
- Leximi i fjalëve me shkronja rrëshqitëse (shih më poshtë ushtrimin c).
- Fjalët rimuese të gjenden për fjalë të shpeshta (topi – shkopi – i mirë – i lirë ...).
- Në një tekst – për shembull, në një artikull gazete apo në një kopje të një tregimi – të kërkohen një ose më shumë fjalë të shpeshta dhe të ngjyrosen (p.sh., «shumë», «tepër», «ndoshta», ose fjalë që shfaqen herë pas here në këtë tekst).
- Të lidhen fjalët: N marrin një fletë me çifte fjalësh, që i takojnë një grupi, por të cilat janë shkruar të ndara dhe të ngatëruara. Tani ju duhet të lidhni me shigjeta, ato fjalë që i takojnë një bashkësie (p.sh. mekanik – kaçavidë; qen – leh etj).

Vërejtje:

- Shumë ushtrime janë mirë të përshtatshme për përforsim në punën me partner.
- Shumë nga ky lloj fletësh të ushtrimit mund t'i bëjnë N e vjetër për të rinjtë.
- Sigurisht, ushtrimet e këtij lloji, nëse është e nevojshme mund të kryhen gjithashtu me N e vjetër, në qoftë se ata ende kanë paqartësi në identifikimin e grafemës në gjuhën e parë.

Ushtrimi a)

**Lexoji fjalët mundësisht pa gabime.
Lexoji disa herë dhe rrite shpejtësinë.**

Shqipëria e ka shtetë të kthyer pors? grup dhe thënë
po5si shtëza të mprehtë. Shqipo%a ha z*gj të gjllë,
le=uj, bre=ka dhe ha&dhuca. Asnjë nga z?gjte nuk i d&l
kund*r shqi%onjës.

Ushtrimi b)

Merr një fletë letre. Mbuloje me të tekstin poshtë. Mbuloje tani shkurtimisht rreshtin e parë dhe thuaj atë që ke lexuar. Pastaj mbuloje shumë shkurtimisht rreshtin e dytë, dhe kështu me radhë. Përsërite këtë ushtrim disa herë.

**ku
vetëm tek
edhe pse ishte atje
megjithatë pas pak u duk**

Ushtrimi c)

**Këtu kanë rrëshqitur shkonjat. Lexoje tekstin disa herë,
derisa të mund ta lexosh atë pa gabime dhe shpejt**

Fëmijët lindin e rriten në familjen e vet. Familja është prrethi ku fëmijët gjejnë daishurinë, ngrohtësinë e siguruinë për jetë. Ndikimi i familjes në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve është i madh. Familja me mënyrën e saj të trajtimit dhe edukimit të fëmijëve ndikon në formimin dhe zhvillimin e karakterit të tyre. Maturësia e familjes, niveli i shkollimit të prindërve por edhe kushtet në të cilat rriten fëmijët ndikon shumë në personalitetin dhe karakterin e tyre.

22

Unë i shoh fjalitë si tërësi

Qëllimi

Ushtrimi bazohet në propozimet 20 dhe 21, dhe vazhdon më tutje në fushën e pjesëve të fjalisë. Njohja, plotësimi dhe lidhja e elementeve të caktuara të fjalisë lehtëson shtjellimin e kuptimeve dhe kështu edhe procesin e leximit.

kl. 1–4

10–15 min.



Materiali:
Varësisht nga ushtrimi fletë të parapërgatitura, shih më poshtë

Rrjedha:

Qëllimi i një identifikimi mundësisht të rrjedhshëm dhe interpretimi i elementeve veçanërisht të shpeshta të fjalisë në gjuhën e parë mund orientohet me ushtrime të ndryshme. Shembuj:

- Nga fjalia xhuxh tek fjalia gjigante (shih më poshtë ushtrimi a; mund të bëhet më së miri me shirita të gjatë të letrës).
- Fjalitë të plotësohen (shih më poshtë ushtrimi b).
- Pjesët e fjalisë të lidhen: Për këtë M e jep një fletë të ndarë në mes me një vijë. Majtas janë 15 fillime të fjalive, djathtas – në renditje të ndryshme! – gjysma e fundit e këtyre fjalive. Tani N duhet t'i lidhin me shigjeta me njëra-tjetrën fillimet e fjalive përkasëse me pjesët përfundimtare të fjalive. (P.sh.: Në verë lahem → me dëshirë në det).

Vërejtje:

- Shumë ushtrime janë më të përshtatshme për përpunim në punën me partner.
- Shumë nga ky lloj fletësh të ushtrimit mund t'i bëjnë N e vjetër për të rinjtë.
- Sigurisht, ushtrimet e këtij lloji, nëse është e nevojshme, mund të kryhen gjithashtu me N e vjetër, në qoftë se ata ende kanë paqartësi në identifikimin e grafemës në gjuhën e parë.

Ushtrimi a)

Lexoji fjalitë vijuese disa herë.

Agimi hedh kripë.

Agimi hedh fshehurazi kripë.

Agimi hedh fshehurazi kripë në çaj.

Vëllai im Agimi hedh fshehurazi kripë në çaj.

Vëllai im i prapët Agimi hedh fshehurazi kripë në çaj.

Vëllai im i prapët Agimi hedh fshehurazi kripë në çajin e nxehtë të nënës.

Ushtrimi b)

Kërkoje me sy djathtas pjesën që mungon; fute brenda në tekst.

Është _____ e së premtes. ora e fundit
_____ ulen në rreth. Fëmijët
Mësuesja rrëfen _____. një tregim

23

Unë kuptoj atë që e lexoj

Qëllimi

Ushtrimi i të kuptuarit në fushën e fjalisë dhe/ose të tekstit të shkurtër.

kl. 1–5

10–15 min.



Materiali:
Varësisht nga ushtrimi
fletë të parapërgatitura,
shih më poshtë.

Rrjedha:

Të kuptuarit e tekstit në fushën e vogël të një fjalie të vetme dhe/ose të tekstit të shkurtër mund të ushtrohet me ushtrime të ndryshme. Shembuj:

- Të krahasohen tekstet dhe ilustrimet. Për këtë qëllim, për shembull, jepen dy fletë; në fletën e parë ka tetë fjali ose tekste të shkurtra (nr. 1–8), në të dytën, janë tetë imazhe (a–h). Tani duhet të gjenden nënrenditjet (p.sh. «Teksti 1 i përshtatet ilustrimit d»).
- Tekstet të renditen (shih më poshtë ushtrimi a).
- Të gjenden gabimet në tekste (shih më poshtë ushtrimin b).
- Të kuptohen fjalitë, ushtrimi i leximit të kuptueshëm: Për këtë qëllim, për shembull, t'u jepet një fletë me 20 thënie (P.sh.: «Qentë mund të fluturojnë», «Në Turqi, fliten gjuhë të ndryshme»). Për çdo thënie duhet të shënohet «e vërtetë» ose «nuk është e vërtetë».

Vërejtje:

- Shumë ushtrime janë më të përshtatshme për përpunim në punën me partner.
- Shumë prej këtij lloji të fletëve të ushtrimit mund t'i bëjnë N e vjetër për të rinjtë.
- Sigurisht, ushtrimet e këtij lloji, nëse është e nevojshme, mund të kryhen gjithashtu me N e vjetër, në qoftë se ata ende kanë paqartësi në identifikimin e grafemës në gjuhën e parë.

Ushtrimi a)

Këtu janë dy tekste krejt të ndryshme të përziera. Merr dy lapsa me ngjyra të ndryshme dhe nënvizo, çfarë i përket një bashkësie!

Pushtimi i hapësirës është një ëndërr e vjetër e njerëzimit. Genti qëndron zgjuar. Në krahët e tij ai mban Mo. Në vitin 1969, startuan tre astronautët në Amerikë. Ata fluturuan me një raketë në Hënë. Mo është duke fjetur shumë fort. Mo është një gorillë shtofi e Gentit. Genti e merr atë kudo. Neil Armstrong-u është njeriu i parë që shkeli në Hënë. Jo vetëm në shkollë. Mësuesit nuk i pëlqejnë gorillat. Astronautët morën gurë nga hëna dhe i sollën në Tokë.

Ushtrimi b)

Këtu janë futur enkas 6 gabime. Nënvizoji ato!


Komposto molle

Përbërësit:

6 mollë të tharta, sheqer, kanellë, shumë pak ujë

Ja se si përgatitet:

Merrni bananet, qëroji ato dhe preni në copa. Tani merr një libër, hedhe pak ujë në të. Vendose tiganin në makinën larëse dhe vendosi tri mollë së bashku me rreth 3 lugë kripë në të. Tani duhet t'i lësh të flenë rreth 8–10 minuta në një nxehtësi të mesme dhe t'i përziesh, në mënyrë që të mos digjen. Nëse copat e mollëve janë të gjelbra, komposti është gati. Tani ti mund të hedhësh në të edhe pak benzinë.



24

Të ushtrohet rrjedhshmëria

Qëllimi

Qëllimi i ushtrimit të rrjedhshmërisë (Fluency) është për të përmirësuar aftësitë në të lexuar. Nuk ka dyshim se, mes rrjedhshmërisë së mirë në të lexuar (në gjendje të lexojë rrjedhshëm dhe pa gabime) dhe kompetencës në të lexuar, qëndron një lidhje e drejtpërdrejtë. Është e rëndësishme që ushtrimet të bëhen për një kohë të gjatë (në MGJP për të paktën 4–6 javë), ku 10–15 minuta janë të mjaftueshme për këtë pjesë ushtrimi. Koha e investuar këtu absolutisht ia vlen, kjo edhe kur përparimet në të lexuar të N janë drejtpërdrejt të dukshme, e të cilat në parim çojnë në një vetëkoncept më të mirë. Duke pasur parasysh moshat dhe nivelet e ndryshme të N në MGJP tekstet e ushtrimit duhet të jenë të përgatitura të paktën në tri nivele.

kl. 1–9

10–15 min.



Materiali:

Tekste të përgatitura për grupmosha dhe nivele të ndryshme; në versionet e leximit dhe fletës së kontrollit dhe gjithmonë me pyetjet për vetëvlerësim, përkatësisht për kohën e leximit dhe përmbledhjes (Feedback) (shih për këtë dhe për gjatësinë e teksteve më poshtë); kronometër.

Rrjedha:

- Para fillimit të periudhës së ushtrimeve disajvare M i informon N mbi qëllimin e rrjedhes së këtij ushtrimi. Në këtë rast ai/ajo mund ta përmend se ushtrimi në të lexuar në gjuhën e parë i shërben edhe të lexuarit në mësimin e rregullt. Gjithashtu në këtë hyrje duhet që përvojat dhe teknikat të cilat ndoshta tashmë i dinë N nga mësimi i rregullt t'i tematizojnë.

Udhëzime për zhvillimin konkret:

- Është e rëndësishme që N të udhëzohen pikërisht para fillimit të ushtrimeve, në mënyrë që ata të mund ta përfundojnë ushtrimin e tyre, mundësisht në mënyrë të pavarur. Nëpërmjet kësaj M gjen kohë për të vëzhguar saktë N të veçantë, për t'i shoqëruar dhe këshilluar ata.
- Të dëgjuarit e koncentruar të kjo pjesë e ushtrimit është poaq i rëndësishëm sa edhe të lexuarit e mirë. Edhe të dëgjuarit duhet të ushtrohet në fillim me tërë klasën (dikush lexon me zë të lartë, të tjerët i nënvizojnë gabimet në të lexuar).
- Rrjedhshmëria në të lexuar do të ushtrohet në dyshe. Dyshet formohen nga dy N të të njëjtit nivel ose grupmoshë. Dallimi në aftësitë e leximit të të dyve nuk duhet të jetë shumë i madh.
- Kujdes duhet t'i kushtohet saktësisë së leximit dhe shpejtësisë së leximit. Për këtë arsye, në këtë ushtrim gjithashtu mund të përdoret një kronometër (për kohët e përafërta shih më poshtë).
- Në varësi të moshës së N dhe varësisht nga intensiteti i ushtrimit do të bihet dakord para leximit, se për cilat aspekte të veçanta dhe për çfarë gabimesh të mundshme do të kihet vëmendje e veçantë:
 - Rrjedhshmëria e leximit (pengesat)
 - Saktësia e leximit (shkarje e gjuhës, lënia jashtë e një fjale, fjalët e lexuara keq etj).
 - Qartësia në të lexuar (rrokjet e gëlltitura, vëllimi i përshtatshëm etj).
 - Shprehësia në të lexuar (leximi monotoni, lexon mërzitshëm etj).

- Secila dyshe tani merr një tekst, një herë si një fletë leximi, një herë si një fletë kontrolli (shih shembullin më poshtë). Tekstet duhet të jenë të përgatitura në nivele të ndryshme, në mënyrë që N e të gjitha moshave dhe niveleve të mund të ushtrohen në mënyrë të përshtatshme. Tek grupet dyshe do të bihet dakord, kush lexon i pari (N1) dhe cili dëgjon (N2).
- N1 e lexon tekstin para tjetrit, për të parën herë, dhe pastaj u përgjigjet pyetjeve të shënuara poshtë në fletë (Vlerësimi i vështirësisë; «këtë do ta marr parasysh herën tjetër»). N2 mat kohën, të cilën e ka përdorur për të lexuar, e shënon në fletën e kontrollit dhe jep një shpërfaqje («Këshilla ime për ty»).
- N1 lexon tekstin para tjetrit për të dytën dhe të tretën herë. Pas secilit lexim pasojnë vetëvlerësimi, matja e kohës dhe shpërfaqja (Feedback) si më lart e dhënë.
- Ndërrim rolesh; tani N2 lexon tekstin (apo një tekst tjetër të po të njëjtit grup niveli) tri herë dhe N1 mat kohën dhe i jep shpërfaqjen.
- Fletët e kontrollit do të mbliidhen. Nëpërmjet shënimeve të rregullta të dëgjuesve krijohet një lloj ditari i të lexuarit para të tjerëve, i cili i dokumenton përparimet.
- Periodikisht duhet të bëhet një diskutim i shkurtër në klasë: Çfarë keni bërë për përparimin, çfarë keni vënë re etj.

Udhëzime:

- Nuk duhet kurrësi të jetë objektiv i ushtrimit që N të lexojnë tekstet sa më shpejt të jetë e mundur dhe të zhvillojnë një lloj konkurrence. Për këtë arsye do të vendosen paraprakisht qëllimet orientuese në përputhje me moshën dhe aftësitë. Për lexuesit/et fillestarë janë rreth 65 fjalë në minutë; për N të cilët mund të lexojnë më mirë janë 100 fjalë për minutë; për lexuesit/et e dalluar janë rreth 130 fjalë për minutë.
- Për gjatësinë e teksteve: Tekstet janë për t'u lexuar në rreth 90 sekonda. Kjo rezulton në një sasi prej rreth 100 fjalë për nivelin 1, rreth 150 fjalë për nivelin 2 dhe në deri në 200 fjalë për nivelin 3.
- Në çdo fletë leximi dhe fletë kontrolli duhet të jenë pyetjet për vetëvlerësimin gjegjësisht për të matur kohën dhe për të gjetur «Udhëzimi im për ty», shih tek shembujt më poshtë.
- Optimale në aspektin e frytshmërisë dhe qëndrueshmërisë do të ishte në qoftë se trajnimi i rrjedhshmërisë në MGJP do gërshetohej me mësimin e rregullt (ose të paktën me disa mësues të klasëve të rregullta). E vlefshme është, gjithsesi, të lihet të shpjegohet nga mësuesit e klasëve, mundësisht në bazë të teksteve gjuhësore, se cilat ushtrime të përshtatshme tashmë i dinë N nga mësimi i rregullt.
- Është me shumë vlerë që leximet kohë pas kohe të incizohen në një fonogram. Në rrjedhën e programit të ushtrimit do të krijohet në këtë mënyrë një lloj biografie e leximit: lexuesit mund të dëgjojnë nga incizimet e vëna njëra pas tjetrës përparimet e tyre në të lexuar dhe në bazë të nënvizimeve të gabimeve të pakësuar edhe t'i shohin ato në protokolle.

Shembull fletë leximi

(niveli i mesëm, 156 fjalë)



Si arriti njerëzimi te libri?

Kur njohuritë u shtuan aq shumë saqë nuk mund të mbaheshin mend, njerëzit u detyruan të përdorin shenja e vizatime të ndryshme. Në muret e shpellave janë gjetur vizatime, që tregojnë ngjarje nga gjahu, lufta etj. Në kohët e para, njerëzit shkruanin në objekte të ndryshme prej guri, bronzi, druri e në lëkurë bagëtish. Në vitin 105, kinezët shpikën letrën. Që atëherë librat filluan të shkruhen në letër. Librat shkruheshin me dorë. Vetëm një libër kopjohej për disa vjet. Për shkak të kësaj mënyre të përgatitjes, libri ishte gjë e rrallë. Që kur Gutenbergu shpiku shtypshkronjën, në shekullin XV, dhe që kur letra filloi të prodhohej prej drurit, në shekullin XIX, libri u bë pronë e një mase të gjërë njerëzish. Sot në botë shtypen çdo vit libra në miliona kopje. Libri është një nga shpikjet dhe thesaret më të mrekullueshme të njerëzimit. Aty ruhet, çdo gjë që mësoi dhe zbuloi njeriu. Libri është e duhet të jetë për njeriun shok i pandarë, shok që të mëson, mik që të çlodh, që të bën ta kalosh kohën e lirë në mënyrë të këndëshme e të frytshme.

Leximi i këtij teksti ishte për mua:

- i lehtë
- gati i lehtë
- gati i vështirë
- i vështirë

Këtë do ta bëj herën tjetër:

- Unë përpiqem të lexoj saktë.
- Unë përpiqem të lexoj rrjedhshëm.
- Unë përsëri do të lexoj mirë.
- Unë ...

Shembull fletë kontrolli

Si arriti njerëzimi te libri?

Kur njohuritë u shtuan aq shumë saqë nuk mund të mbaheshin mend, njerëzit u detyruan të përdorin shenja e vizatime të ndryshme. Në muret e shpellave janë gjetur vizatime, që tregojnë ngjarje nga gjahu, lufta etj. Në kohët e para, njerëzit shkruanin në objekte të ndryshme prej guri, bronzi, druri e në lëkurë bagëtish. Në vitin 105, kinezët shpikën letrën. Që atëherë librat filluan të shkruhen në letër. Librat shkruheshin me dorë. Vetëm një libër kopjohej për disa vjet. Për shkak të kësaj mënyre të përgatitjes, libri ishte gjë e rrallë. Që kur Gutenbergu shpiku shtypshkronjën, në shekullin XV, dhe që kur letra filloi të prodhohej prej drurit, në shekullin XIX, libri u bë pronë e një mase të gjërë njerëzish. Sot në botë shtypen çdo vit libra në miliona kopje. Libri është një nga shpikjet dhe thesaret më të mrekullueshme të njerëzimit. Aty ruhet, çdo gjë që mësoi dhe zbuloi njeriu. Libri është e duhet të jetë për njeriun shok i pandarë, shok që të mëson, mik që të çlodh, që të bën ta kalosh kohën e lirë në mënyrë të këndëshme e të frytshme.

(156 fjalë, koha e përcaktuar: 1 minutë, 30 sekonda)

Koha e leximit: 1. Leximi _____ minuta _____ sekonda
Koha e leximit: 2. Leximi _____ minuta _____ sekonda
Koha e leximit: 3. Leximi _____ minuta _____ sekonda

Këshilla ime për ty::

- Përpiqu, të lexosh saktë.
- Lexo përsëri mirë kështu.
- Përpiqu, të lexosh rrjedhshëm.
- Diçka tjetër ...

25 Strategjitë para se të nisë të lexuarit

Qëllimi

Nëse lexuesit/et e dinë se si të përgatiten për një detyrë të ardhshme në të lexuar, është më e madhe mundësia që procesi i të lexuarit dhe të kuptuarit të ketë vërtet sukses. Nëpërmjet këtij ushtrimi N mësojnë të njohin dhe të zbatojnë një strategji të dobishme për këtë qëllim.

kl. 3–9

30 min.



Materiali:

Tekstet aktuale nga mësimi, tregime të shkurtra, tekste faktike, libra, revista. Duhet të përgatiten materiale për 2–3 grupmosha të ndryshme dhe nivele të aftësive.

Rrjedha:

- Hyrja, Njoftim paraprak: M tregon dhe ilustron me një shembull konkret se si në tre hapa mund të vlerësohet dhe të njihet një tekst para se të lexohet.

Për këtë shtrohen pyetje për tekstin, si p.sh.:

- Çfarë pres nga ky tekst; cila mënyrë e të lexuarit ka kuptim (a duhet ta kaloj tekstin fluturimthi; a duhet ta kuptoj atë deri në detajet e fundit, apo dua të kërkoj vetëm një informacion të caktuar)?
- Cilës gjini a zhanër/ cilit lloj i përket ky tekst?
- Sa i vështirë më duket mua ky tekst; ku mund të qëndrojnë vështirësitë dhe çfarë mund të bëj për ta përballuar atë?
- A kam nevojë për njohuri paraprake për ta kuptuar këtë tekst?
- Për punën e tashme dhe për të gjitha ushtrimet e mëvonshme a duhet të vlejnjë hapat vijues, të cilët N i marrin me shkrim ose i kopjojnë nga dërrasa e zezë:
 - **Të njihet tema dhe forma e tekstit:** përmbajtje të caktuara të tekstit të perceptohen me vetëdije (imazhe, tabela, titujt etj.).
 - **Njohuritë paraprake të bëhen të qarta:** të shënohen fjalët çelës për temën, të formulohen hamendjet dhe pyetjet në lidhje me përmbajtjen.
 - **Të bëhet një lexim provues:** disa fjali të lexohen saktë dhe pastaj të mendohet se si mund të lexohet më së miri i tërë teksti dhe se sa kohë do të jetë e nevojshme për këtë.
- Tani N marrin tekste të ndryshme (sipas moshës dhe dallimit të niveleve) dhe i bëjnë të tre hapat në mënyrë të pavarur. Kjo mund të bëhet nëpërmjet punës individuale ose me partner.
- Së fundmi, vijon një shkëmbim i shkurtër përvoja me këtë procedurë.

Vërejtje:

- Ushtrimet e këtij lloji vetëkuptohet duhet të zhvillohen disa herë, duke përdorur tekste të ndryshme.
- Ushtrimet nr. 25–27 janë të lidhura ngushtë mes tyre dhe duhet edhe N t'u paraqiten në këtë kontekst dhe të ushtrohen me to.
- Hapat e përshkruar më sipër, së bashku me hapat tek nr. 26 dhe 27, mund të shënohen në një fletë pune, me titull «Strategjitë e leximit».

26

Strategjitë gjatë të të lexuarit

Qëllimi

Për të rritur aftësitë e tyre në të lexuar, N duhet, së pari, të njohin dhe të ushtrojnë në mënyrë të vetëdijshme dhe të qëllimshme fjalët «e vështira» ose pjesët e tekstit. Së dyti, duhet që të mprehet vetëdija e tyre për mesazhet kryesore të tekstit (për çfarë bëhet fjalë në tekst, cilat janë pikat e tij kryesore?).

kl. 3-9

30 min.



Materiali:

Tekstet aktuale nga mësimi, tregime të shkurtra, tekste faktike, libra, revista. Duhet të përgatiten materiale për 2-3 grupmosha dhe nivele të ndryshme të aftësive.

Rrjedha:

- M tregon në bazë të një ose disa shembujve se si mund të kapërcehen vështirësitë në tekst dhe se si mund të njihen pjesët kryesore të tekstit. Kjo bëhet më së miri kur M i bën vetë në mënyrë konkrete hapat e duhur dhe «mendon me zë të lartë».
- Në qendër janë dy hapa vijues, të cilët N i marrin me shkrim ose i kopjojnë nga dërrasa e zezë:
 - **Të njihen pjesët e vështira, të sqarohen dhe të kuptohen**, lexim i vetëdijshëm, lexim i përsëritur, të kërkohen vetësvarime në tekst, të shfrytëzohen si ndihmë edhe leksikonet, fjalorët dhe interneti.
 - **Identifikimi i mesazheve kryesore (çelës):** teksti të ndahet në pjesë kuptimore, të formulohen tituj për çdo pjesë a kapitull, të shënohen fjalët çelës.



- Pasi procesi të jetë krejt i qartë për të gjithë, N marrin tekste të ndryshme (sipas moshës dhe niveleve të diferencuara) dhe ushtrojnë në mënyrë të pavarur njohjen e mesazheve kryesore të një teksti të dhënë, në bazë të dy pikave të mësipërme. Kjo mund të bëhet nëpërmjet punës individuale ose me partner.
- Së fundmi, vijon një shkëmbim i shkurtër për përvojat me këtë procedurë.

Vërejtje:

- Vetëkuptohet që ushtrimet e këtij lloji duhet të zhvillohen disa herë, duke u përdorur tekste të ndryshme.
- Ushtrimet nr. 25–27 janë të lidhura ngushtë mes tyre dhe duhet edhe N t'u paraqiten në këtë kontekst dhe të ushtrohen me to.
- Hapat e përshkruar më sipër, së bashku me hapat tek nr. 25 dhe 27, mund të shënohen në një fletë pune, me titull «Strategjitë e leximit».
- Strategjitë dhe udhëzimet për evidentimin e mesazheve çelës mund të gjenden edhe në broshurën «Dhënia e strategjive dhe teknikave mësimore në MGJP» (Fletorja 5 e serisë «Nxitje didaktike për MGJP»; krahaso aty nr. 9 «Të nënvizohet më e rëndësishmja në një tekst».

27 Strategjitë pas të të lexuarit

Qëllimi

N duhet të mësojnë, së pari, se si mund të përmbledhin tekstet në përfundim të të lexuarit. Në varësi të llojit të tekstit janë të dobishme forma të ndryshme. Ata, së dyti, duhet të mësojnë dhe të ushtrojnë, se si mund të formojnë një opinion të pavarur mbi cilësinë e tekstit dhe të mund edhe ta arsyetojnë këtë.

kl. 3–9

30 min.



Materiali:

Tekstet aktuale nga mësimi, tregime të shkurtra, tekste faktike, libra, revista. Duhet të përgatiten materiale për 2–3 grupmosha dhe nivele të ndryshme të aftësive.

Rrjedha:

- M sqaron dhe tregon se si mund të përmbledhen përmbajtjet në mënyra dhe forma të ndryshme. Kjo duhet të bëhet në bazë të teksteve të ndryshme (tekste për 2–3 nivele të kërkesave në 2–3 lloje të teksteve, për shembull, me tekst faktik, tekst historik). Pastaj, së bashku me klasën, do të diskutohet dhe ushtrohet vlerësimi dhe arsyetimi i mendimit personal për një tekst.
- Për punën e mëvonshme vlejné këta hapa, të cilët N i marrin me shkrim ose i kopjojnë nga dërrasa e zezë, pasi të sigurohet se ata e kanë kuptuar atë:
 - **Të përmbledhet përmbajtja:** varësisht nga teksti janë të dobishme forma të ndryshme, për shembull: tabela, lista kronologjike/afati kohor, luajtja e roleve, ritregimi, paraqitja grafike etj.
 - **Tekstet të vlerësohen:** pas leximit duhet që pyetjet të diskutohen dhe të jepen përgjigjet në këtë formë: A të ka pëlqyer teksti? Çfarë gjëje interesante gjete në të? Çfarë ishte e re për ty? Cili është mendimi yt mbi përmbajtjen e tekstit? Kujt mund t'ia rekomandosh tekstin?
- Pasi që të gjithë ta kenë kuptuar procedurën, N marrin tekste të ndryshme (sipas moshës dhe niveleve të diferencuara) dhe ushtrohen për të përmbledhur dhe formuluar një gjykim të arsyetuar në bazë të dy pikave të mësipërme. Kjo mund të bëhet nëpërmjet punës individuale ose me partner.

Vërejtje:

- Ushtrimet e këtij lloji, vetëkuptueshëm, duhet të zhvillohen disa herë, duke përdorur tekste të ndryshme.
- Ushtrimet nr. 25–27 janë të lidhura ngushtë mes tyre dhe duhet t'u paraqiten edhe N në këtë kontekst dhe të ushtrohen me ta.
- Hapat e përshkruar më sipër, së bashku me hapat tek nr. 25 dhe 26, mund të shënohen në një fletë pune, me titull «Strategjitë e leximit».
- Strategjitë dhe udhëzimet për të bërë përmbledhjet mund të gjenden edhe në broshurën «Dhënia e strategjive dhe teknikave mësimore në MGJP» (Fletorja 5 e serisë «Nxitje didaktike për MGJP»); krahaso aty nr. 10 «Të bëhen përmbledhje të mira».

**Pjesa III:
Arsimimi
letraro-kulturor**

Ka përplot forma se si mund të përkrahët të kuptuarit letrar në mësim.

Propozime mësimore 28–30

Një qëllim i rëndësishëm i mëimit në gjuhën e prejardhjes është që nxënësit/et ta përjetojnë bukurinë e gjuhës së tyre të prejardhjes, të futen në larminë kulturore të vendit të tyre dhe ta pasurojnë thesarin e tyre ditunor, duke njohur nga afër dëshmitë letrare të kulturës së tyre të origjinës – përrallat, tregimet, rrëfimet, poezitë etj. Çdo vend, çdo kulturë ka tregime të veçanta, ka thesare të pasura legjendash, përrallash dhe tregimesh tradicionale.

Në mënyrë që nxënësit/et vërtet të mund të përfytyrojnë përmbajtjen e këtyre teksteve, shumë prej tyre, megjithatë, kanë nevojë për ndihmë. Kjo vlen veçanërisht për dy grupet e nxënësve/eve: për ata nga familjet më pak të arsimuara, të cilët në shtëpi nuk kanë asnjë qasje në literaturën e kulturës së tyre të prejardhjes, dhe për ata, për të cilët vendi i tyre i prejardhjes nuk është mjaft i njohur, për shkak se ata më të shumtën i kalojnë pushimet e tyre atje. Shpesh, megjithatë, jo vetëm vendet e veprimt janë të panjohura, por edhe personazhet dhe marrëdhëniet e tyre (Legjenda me figurën e Rozafës është e njohur për çdo fëmijë në Shqipëri, por jo në emigracionin shqiptar). Përveç kësaj, në vendet e prejardhjes shpesh dalin në pah vlera të tjera nga ato në vendin e mërgimit dhe letërsia e atjeshme njihet pjesërisht në norma të tjera, tradita, role gjinore, rituale dhe sjellje. Edhe kjo mund të çojë tek problemet dhe irritimet.

Më poshtë, me anë të shembujve do të paraqitet se si mësimdhënësit në MGJP nxënësve/eve të tyre ua mundësojnë përvojat letrare d.m.th. me tekste krijuese gjuhësore dhe si mund të ushtrohet të kuptuarit letrar të teksteve me detyra të ndryshme.

Qëllimi

N duhet të kenë mundësi të përjetojnë në mënyrë ndijimore bukurinë e gjuhës së tyre të prejardhjes. Të dëgjuarit duhet t'i sensibilizojë ata për të dëgjuar me vëmendje ritmin dhe melodinë dhe për të shijuar estetikën e gjuhës krijuese. Si bazë për përjetimin e dëgjimit mund të shërbejnë, p.sh., poezitë, të cilat mund të gjenden në platformën e internetit www.lyrikline.org (shih më poshtë).

kl. 5–9

30–45 min.



Materiali:
Mundësisht qasje në internet,
nëse është e mundshme edhe
printerit.



Rrjedha:

- Variante me qasje në platformën e internetit www.lyrikline.org: Mësuesi paraqet faqen e internetit. Më pas, formohen grupe dyshe. Ata duhet të kërkojnë në platformën e internetit një poezi lirike në gjuhën e tyre të prejardhjes, e cila u pëlqen veçanërisht. Ata pastaj do t'ia paraqesin atë klasës, dhe të futen në trajtimin e çështjeve në formën vijuese:
 - Si mund të njihet se po bëhet fjalë për një poezi?
 - Cila është tema kryesore e poezisë?
 - Cilat fjalë ose fraza tingëllojnë veçanërisht bukur?
 - Çfarë atmosfere mbizotëron në këtë poezi?
 - Cilat ngjyra apo çfarë lloji i muzikës është i përshtatshëm për poezinë?
 - Kujt mund t'i pëlqejë veçanërisht kjo poezi?
- Nëse në MGJP nuk ka kompjutera në dispozicion, kërkimi mund të bëhet si detyrë shtëpie. Regjistrimi i poezisë duhet të silllet si një audio file në telefonin e dorës.
- Në vend të www.lyrikonline.org ose si shtesë për këtë, të dëgjuarit natyrisht mund të përjetohet e të dëgjohet edhe me tekste të tjera dhe lexues/e: poezi lirike për fëmijë, tregime të shkurtra, gazmore etj. të lexohen nga mësuesit, prindërit, nga nxënësit/et (pas përgatitjes së mirë) dhe mundësisht të incizohen, për të bërë për shembull një CD nga audio file-t (krahaso këtu gjithashtu edhe sugjerimin mësimor 10, Të lexuarit e modeluar për të tjerët).

Vërejtje:

- Për platformën e poezive lirike www.lyrikline.org: Kjo faqe interneti – një thesar i vërtetë! – ofron poezi në më shumë se 60 gjuhë, të lexuara nga vetë autori/ja dhe është e plotësuar me detaje biografike të tyre. Shpesh ka edhe një përkthim në gjermanisht ose në gjuhët e tjera në të cilat kjo faqe mund të përdoret. Për të përdorur këtë faqe interneti: Së pari, duhet të zgjidhet gjuha e kërkimit, pastaj mund të jepet në rubrikën «specifikimi për kërkim» emri i gjuhës në të cilën ju do të donit të keni poezi..

Variantet:


Ka mundësi të shumta për zgjerime dhe përmirësime, p.sh.:

- Tekstet (shpesh me përkthim) mund të shtypen dhe të kopjohen, kështu janë të mundshme edhe krahasimet dhe vështrimet gjuhësore.
- N e ushtrojnë të lexuarit e poezisë së tyre të preferuar dhe e lexojnë vetë atë para klasës.
- N dëgjojnë poezi edhe në gjuhë të tjera, vendosin për një përjetim veçanërisht të bukur të të dëgjuarit dhe/ose bëjnë krahasime me gjuhën e tyre (tingëllimi, ritmi gjuhësor, melodia, shpejtësia etj.).

29 Personazhet e librave

Qëllimi

Projekti i ndihmon N për të ndërtuar një marrëdhënie emocionale ndaj një teksti (tregimi apo libri). Duke krijuar një portret të personazhit kryesor ose të një figure tjetër të rëndësishme gjatë rrjedhës së leximit, ata thellohen në këtë figurë dhe në atë se çfarë ajo përjeton dhe pëson. Ky thellim dhe identifikim mund të jetë vendimtar nëse N i kuptojnë veprimet dhe marrëdhëniet midis personazheve.



Materiali:
Tregimi, rrëfimi ose libri i tërë
(edhe si libër i ilustruar);
letër dhe lapsa me ngjyra.

Rrjedha:

- Gjatë ose pas leximit të një tregimi apo një libri (edhe libër për lexim para të tjerëve-ose libër i ilustruar) N krijojnë një portret apo një profil të karakterit kryesor ose të disa figurave. Kjo mund të bëhet si punë individuale apo me partner. Më parë do të diskutohen disa pika të cilat mund të ndodhin në këtë portret apo profil; p.sh.:
 - Ku banon personazhi?
 - Cili është personazhi?
 - Çfarë mund të bëjë ky personazh shumë mirë, e çfarë jo?
 - Çfarë shqetësimesh e rëndojnë personazhin?
 - Çfarë di në lidhje me familjen e këtij personazhi?
 - Cilët njerëz janë të rëndësishëm për personazhin?
 - A do të të pëlqente që këtë personazh ta kesh shok/shoqe dhe pse po ose pse jo?

- Përveç përgjigjeve me shkrim portreti duhet të përfshijë edhe një krijim ilustrues.
- Portretet do të diskutohen, krahasohen e plotësohen pastaj në grupe ose në bashkësinë e klasës.

Çfarë bën personazhi në tregim?

(Qëndron shpesh në tekst.)



Çfarë mendon personazhi?

(Mendimet janë shpesh mes rreshtave.)

Vërejtje:

Natyrisht projekti mund të bëhet edhe me N të klasave 7–9; ndoshta këtu me një orientim kognitiv (vështrime me shkrim për figurën, shkëmbim fiktiv përmes e-mail-it ose intervistë me të etj.).

30

Të prezantohet një vend përmes ilustrimeve

Qëllimi

Ushtrimi do të duhej që t'i udhëheqë N në fushën e imagjinatës, të intuitës së brendshme dhe të përfytyrimit të veprimit ose të disponimit. Përfytyrimi i brendshëm është një element i rëndësishëm, kur bëhet fjalë për të kuptuar një tekst. Në të njëjtën kohë, shumë N e kanë të vështirë që të përfytyrojnë vende (ose persona apo disponime) nëse për këtë ata nuk kanë të vendosura imazhe përfundimtare, ashtu siç janë mësuara nga televizioni.

kl. 1–9

45 min.



Materiali:
Tregim ose rrëfim
(mundësisht 2–3 tekste
të niveleve të ndryshme).

Rrjedha:

- M e lexon tregimin para N. Kjo mund të bëhet me tërë klasën, në qoftë se tregimi është i përshtatshëm për të gjitha grupmoshat, ose me tregime të ndryshme të veçanta sipas moshave.
- Në bashkësinë e klasës (ose në grupmoshën gjegjësisht nivelin) do të ritregohet përmbajtja dhe do të sqarohen pyetjet rreth të kuptuarit. Tek tekstet komplekse mund të jepet paraprakisht një kopje në mënyrë që N të mund ta radhitin edhe një herë përmbajtjen për veten e tyre.
- N i mbyllin sytë, ata duhet të përfytyrojnë një vend të rëndësishëm të ngjarjes si në një film. Në këtë përfytyrim mund të ndihmojnë pyetjet vijuese si (këtu në bazë të një dhome, e cila përmendet në tregimin e rrëfyer):
 - A ka ndonjë dritare?
 - Ku është dera?
 - Çfarë mobiljesh ka aty?
 - A është dhoma e errët, a është drita e ndezur apo hyn drita nga jashtë?
 - A ka fotografi në mure?
 - Si ndihesh ti kur je në këtë dhomë; pse?
- Pas disa minutash, kur të gjithë N do të duhej t'i kishin krijuar përfytyrimet e brendshme, e vizatojnë një plan të dhomës ose shkruajnë se si e përfytyrojnë këtë, ose se si ata do të ndjehen në këtë dhomë.
- Pastaj ata kërkojnë një partner apo një partnere, i diskutojnë rezultatet e tyre dhe u jepet përsëri pak kohë për të rishikuar punën e tyre, nëse është e nevojshme (p.sh. sqarimi i disa paqartësive).
- Së fundmi, tekstet dhe vizatimet krahasohen dhe diskutohen në klasë.

Variantet:

- Ushtrimi do të duhej të përsëritet disa herë.
- Ky ushtrim mund të zhvillohet edhe në përshtatje me disponimet dhe ndjenjat ose njerëzit (në vend se vetëm në një mjedis).



Literatura e përdorur

- Bertschi-Kaufmann, Andrea (Hrsg.) (2007): Lesekompetenz – Leseleistung – Leseförderung. Grundlagen, Modelle und Materialien. Seelze-Velber und Zug: Kallmeyer & Klett und Balmer.
- Bibliomedia, QUIIMS (2005): Sprachenvielfalt in Schule und Bibliothek, Solothurn: Bibliomedia.
- Kruse, Gerd; Maria Riss; Ursula Rickli; Thomas Sommer (2010): Lesen. Das Training 1. Bern: Schulverlag plus.
- Kruse, Gerd; Maria Riss; Thomas Sommer (2012): Lesen. Das Training 2. Bern: Schulverlag plus.
- Kruse, Gerd; Maria Riss; Thomas Sommer (2013): Lesen. Das Training 3. Bern: Schulverlag plus.
- Isler, Dieter (2005): Schule und Bibliothek – Zusammenarbeit vor Ort. In: Leseforum 14/2005, S. 51– 53.
Link: www.leseforum.ch/myUploadData/files/14_Bulletin_2005.pdf
- Riss, Maria (2012): Alles und Nichts. Didaktischer Kommentar. Bern: Schulverlag plus.
- Rosebrock, Cornelia et al. (2011): Leseflüssigkeit fördern. Lautleseverfahren für die Primar- und Sekundarstufe. Seelze: Kallmeyer & Klett.
- Rosebrock, Cornelia; Daniel Nix (2008): Grundlagen der Lesedidaktik und der systematischen schulischen Leseförderung. Baltmannsweiler: Schneider Hohengehren.
- Spinner, Kaspar (2007): Lesen als ästhetische Bildung. In: Andrea Bertschi-Kaufmann (Hrsg.): Lesekompetenz – Leseleistung – Leseförderung. Seelze-Velber und Zug: Kallmeyer & Klett und Balmer, S. 83–94.
- Sträuli, Barbara et al. (2005): Leseknick – Lesekick. Leseförderung in vielsprachigen Schulen. Zürich: Lehrmittelverlag des Kantons Zürich.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes (HSU)» përmbledh një radhë të vëllimeve, të cilat kontribuojnë në cilësinë e mësimit në gjuhën e prejardhjes si edhe në lidhjen e saj të mirë me mësimin e rregullt.

Adresantët e kësaj serie janë mësuesit e ardhshëm dhe ata që praktikojnë MGJP-në, si edhe institucionet që përgjigjen për ta në vendet e prejardhjes dhe të emigrimit.

Vëllimi i bazave (doracaku dhe libri i punës. Bazat dhe arsyet) transmetojnë ndër të tjera, pikat më të forta të pedagogjisë, didaktikës dhe metodikës aktuale në Evropën Perëndimore dhe Veriperëndimore.

Vëllimet me nxitje didaktike ofrojnë impulse konkrete dhe planifikime për sfera të ndryshme të mësimit (përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë etj) Të gjitha vëllimet lindën në bashkëpunim të ngushtë me mësues që praktikojnë MGJP-në, kështu që lidhja me praktikën dhe zbatueshmëria konkrete është bashkëmenduar që në krye.

Seria përfshin vëllimet e mëposhtme:



Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» botohet në gjermanisht, anglisht, shqip, në gjuhën boshnjake, kroate, serbe, portugalisht dhe turqisht. Ajo do të publikohet nga Qendra IPE (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut.